



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT BERAT, KORÇE ,ELBASAN .

PROJEKT RAPORT I AUDITIMIT TEMATIK

“PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA”

AGJENCIA RAJONALE E MJEDISIT BERAT, KORÇË, ELBASAN

	Përmbajtja	1-1
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	2-2
	1.Përshkrim i shkurtër Projektit të Auditimit	2-2
	2.Përshkrim i gjetjeve kryesore	2-3
	3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	4-4
II	HYRJE	4-4
	2. Qëllimi	4-4
	3. Identifikimi i çështjes	4-4
	4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	4-4
	5. Përgjegjësitë e audituesve	5-5
	6. Kriteret e vlerësimit	5-5
	7. Standardet e Auditimit	5-5
	8. Metodatat e auditimit	5-5
	9. Dokumentimi i auditimit	5-5
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	5-7
1	Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	5-5
2	Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit	5-5
2.1	Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".	5-5
2.2	Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	6-6
2.3	Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht,sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	6-7
2.4	Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	7-7
IV.	Gjetje dhe Rekomandime	7-9



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT BERAT, KORÇE, ELBASAN .

I. Përmbledhje Ekzekutive

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (në vijim KLSH) ushtroi auditimin tematik me objekt “Mbi nivelin e zbatimit të të rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022” Agjencinë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me verifikimin dhe vlerësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Gjatë auditimit në terren nga grupi i auditimit është mbajtur 1 akt-verifikim, sipas çështjeve respektive, i cili është dorëzuar në protokollin e subjektit. Në përfundim të punës në terren është kryer takimi përmblyës me përfaqësuesit e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan.

1.2. Në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet më të rëndësishme të auditimit, paraqiten si më poshtë vijon:

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	Nga auditimi u konstatua se nga inspektimi i kryer nga sektori i ujërave në subjektet me aktivitet/veprimtari Hec, nuk është kërkuar nëse subjekte HEC apo Hidrocentrale kanë VNM, për ndikim në mjedis sipas ligjit 128/2020, për arsye se në listë verifikimin nuk ka përshkrim si dhe as bazë ligjore për këtë document.	7	E LARTË	Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan t'i kërkojë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Inspektoratit Qendrorë për ndërhyrjen në listë-verifikim për të shtuar një rubrikë, në të cilën të kërkohej dokumenti i Vlerësimit me Ndikim në Mjedis sipas përcaktimeve ligjore.
2.	Nga auditimi u konstatua se formulari i Inspektimit, për paragrafin “I”, pika 3 “Të dhënat të përgjithshme të subjektit”, “Lloji i aktivitetit ekonomik” gjëndërohet nga sistemi dhe plotësohet me numër dhe jo me përshkrimin e aktivitetit në fjalë, gjë që e bën të pamundur të kuptohet lloji i aktivitetit që do të inspektohet kjo nga numri i lartë i aktiviteteve që operojnë në Qarkun e Berat, Korçë, Elbasan .	7	E MESME	Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan të marrë masa, që në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror, të përmirësojnë formatin elektronik, “pikën 3 Lloji i aktivitetit”, të hiqet që të identifikohet saktë veprimtaria dhe aktiviteti i subjektit në rubrikën përkatëse.
3.	Nga auditimi rezultoi se në 26 subjekte që ushtrojnë aktivitet, për nxjerrjen e mineraleve rërës dhe argjilës, nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur, nuk ka dokumentacion mbi Zërat Kadastrale të sipërfaqeve ku zhvillohet ky aktivitet, nqs janë apo jo pjesë e fondit pyjor kullosor që duhet hequr nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore në momentin e pajisjes me			Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan të marrë masa që në bashkëpunim me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të përcaktojnë sipërfaqet janë apo jo pjesë e fondit pyjor kullosor ku zhvillojnë aktivitet subjektet për nxjerrjen e mineraleve për të konstatuar dhe evidentuar situatën e gjendjes së mjedisit, ekzaminimin e dëmtimeve në mjedis të shkaktuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT BERAT, KORÇE ,ELBASAN .

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	leje shfrytëzimi. Veprim në kundërshtim me VKM-së, nr.391 datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave ”pika 8 i cili përcakton: “8.Për shpërblimin e dëmeve të shkaktuara nëfondin pyjor zbatohen tarifat e përcaktuara në lidhjen 8,të shtojcës, që i bashkëlidhet këtij vendimi ”Lidhja 8 “Tarifat e shpërblimit të dëmeve të shkaktuara në fondin pyjor” pika.			nga aktiviteti i tyre si dhe në raste kur ka shkelje të bëhet përcaktimi i vlerës së dëmit dhe kërkimin e rehabilitimit të këtyre parcelave në përputhje me planet e mbarështimit të pyjeve të NJQV-ve.
4.	Nga auditimi u konstatua se: në 5 raste në inspektimet e kryera nga inspektorët në procesverbal thuhet se: “subjekti u gjend i mbyllur”, ose nuk gjendet në adresën e dhënë. Inspektimet janë kryer në mungesë të përfaqësuesit të subjektit dhe nuk është lënë detyrë për paraqitje në ARM për marrje dijeni të problemeve të trajtuara, -Nuk ka verifikime të dokumentuara në sistemin e QKL-së, -Nuk ka dokumente për bashkëpunimin dhe rezultatet e tij me institucione të tjera.Veprime në kundërshtim me nenin Neni 36- Detyrimet e subjektit të inspektimit pika “d”; me ligjin nr. 10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” seksioni 2 neni 62-66 “Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit” si dhe me ligjin nr.10433 datë 16.06.2011“Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” nenin 45-48,ku neni 45; nenin 11“Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimi” të ligjit nr. 10431, datë 9.06.2011“Për Mbrojtjen e Mjedisit.			Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të marrë masa për hartimin e një regjistri me subjektet e konstatuara të mbyllura nga inspektimet dhe të konfirmojë statusin e gjendjes së regjistrimit, aktiv apo pasiv si biznes në QKB



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT BERAT, KORÇE, ELBASAN .

I.3. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Mbështetur në standardet e INTOSAI-t, Manualit të Përputhshmërisë, Manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, nga auditimi tematik i kryer në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan, rezultoi se niveli i zbatimit të rekomandimeve plotësisht, është në nivelin 68%. Rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm janë pranuar plotësisht, ku për përmirësimin e gjendjes janë lënë 21 gjithsej, nga këto 20 masa organizative, 1 masa me 3E. **20 masa organizative**, nga të cilat 13 janë zbatuar, 3 masë pjesërisht dhe 3 masa nuk janë zbatuar. **1 masë me efekt financiar** zbatuar pjesërisht.

II. HYRJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Agjencinë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan, “Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar për periudhën 2022-2023”, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me: verifikimin e respektimit të afatit 20-ditor dhe 6-mujor për kthim përgjigje mbi përgatitjen e plan-veprimit dhe informacionin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve; verifikimin e nivelit të zbatimit të masave për përmirësim ligjor, organizative dhe të ardhura të munguara.

Sipas Programit të Auditimit, nr. 656 datë 17.07.2023, auditimi u krye nga grupi auditues, si vijon:

1. V. B., Përgjegjës Grupi
2. Sh. H., auditues

1. Objektivat e auditimit

Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme, procedurave për ndjekjen dhe dokumentimin e zbatimit të tyre, mbi zbatimin e afatit 20 ditor dhe 6 mujor të kthimit të përgjigjes, si dhe mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e zbatimit të rekomandimeve.

2. Qëllimi i auditimit

Të vlerësojë dhe evidentojë masat e marra nga subjektet përkatëse për zbatimin e rekomandimeve, hartimin e matricave (plan veprimi ose masash) për zbatimin e rekomandimeve. Të vlerësojë aktet administrative përkatëse (urdhrat) të nxjerra për zbatimin e rekomandimeve. Të vlerësojë dokumentacionin që shoqëron dhe vërteton zbatimin e rekomandimeve, si dhe të verifikojë nxjerrjen e vendimeve për fillimin e procedurave administrative për dhënien e masave disiplinore dhe pasqyrimin në dosjen personale të punonjësve. Të verifikojë dhe dokumentojë me kujdes nëse janë ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ato ligjore në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin e shpërblimit të dëmit ekonomik ose gjobave të vendosura.

3. Identifikimi i çështjes

Projekt Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Agjencinë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan dhe përgjegjësive, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Agjencinë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT BERAT, KORCE ,ELBASAN .

me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e objektiv e profesional mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI.

6. Kriteret e vlerësimit

Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikën, është pasur si kriter vlerësues në radhë të parë:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Rregullorja e Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, e ndryshuar me Vendimin nr.107, datë 08.09.2017 të Kryetarit Të KLSH-së.
- Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe regjistri elektronik institucional, miratuar me Vendimin nr.67, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së.

7. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar, si rrjedhojë edhe Projekt Raporti i Auditimit është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, Rregullores së Procedurave të Auditimit, Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

8. Metodologjia e auditimit

1. Auditim i plotë sipas cilësimeve të bëra në drejtimet e auditimit.
2. Verifikimi i Urdhrëve, Udhëzimeve dhe çdo dokumenti ligjor të nevojshëm për zbatimin e rekomandimeve.

9. Dokumentimi i auditimit

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar është përgatitur Projektraporti i Auditimit, i cili do të jetë materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit për ridërgimin e rekomandimeve.

III. PËRSHKRIMI I I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Agjencinë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçe, Elbasan është e organizuar dhe funksionon në bazë të VKM-së, nr.568, datë 17.07.2019, “Për Krijimin dhe mënyrën e Organizimit të Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, dhe Urdhrit nr.23, të Kryeministrit, datë 03.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së AKM-së. Ligjin Nr. 53/2020 "Rregulloren e funksionimit të Agjencisë" dhe akteve të nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm .

2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

1. Hartimi i plan-veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 gërma (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT BERAT, KORÇE, ELBASAN .

Nga auditimi u konstatua se:

- Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 368/8 prot, datë 30.09.2022, ka dërguar në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan Raportin Përfundimtar të Auditimit së bashku me rekomandimet përkatëse.

- Nga Agjencinë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan nuk janë marrë masa për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 15, gërma j.

Nga ana e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan nuk është kthyer përgjigje brenda 20 ditëve për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 gërma (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

- Nga ana e Agjencinë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan nuk janë marrë masa për respektimin e afatit prej 6 (gjashtë) muajsh për raportimin në KLSH me anë të një informacioni të hollësishëm për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim me Ligjin nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 30, pika 2. Me shkresë nr.986prot., datë 15.09.2023 është përcjellë relacioni për zbatueshmërinë e rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Niveli i pranimit dhe statusi sipas llojit të rekomandimit në numër dhe në vlerë

Nga ana e KLSH janë lënë **21 rekomandime** gjithsej, nga këto:

- **20 masa organizative**, nga të cilat 13 janë zbatuar, 3 masë pjesërisht dhe 3 masa nuk janë zbatuar.
- **1 masë me efekt financiar** zbatuar pjesërisht

Pasqyra e realizimit të detyrave të rekomanduara paraqitet si me poshtë:

Nr	Emërtimi	Rekomandimet ne numër :				Nga rekomandimet gjithsej: Sa me dëme ekonomike							
		Rekomandim gjithsej	Nga rekomandimet janë:			Rekomanduar Gjithsej		Nga rekomandimet janë:					
			Zbatuar	Pjesërisht	Pa zbatuar	Nr. per	Në mijë/lek	Zbatuar arkëtuar		Zbatuar pjesërisht		Pa zbatuar	
							Nr. per	Në mijë/lek	Nr. Pers	Në mijë/lek	Nr. pers	Në mijë/lek	
1.	Masa organizative	20	14	3	3	0	0	0	0	0	0	0	0
2.	Masa për përmirësim ligjor	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3.	Shpërbllim demi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
4.	Masa efekt financiar	1	0	1	0	1	50,000	0	0	0	50,000	1	0
	Totali	21	14	4	3	1	50,000	0	0	0	50,000	1	0

2.2. Zbatimi i rekomandimeve për përmirësim në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Duke qenë se nuk nga auditimi i mëparshëm i KLSH nuk janë lënë rekomandime për përmirësim ligjor atëherë kjo pikë e programit ezaurohet me këtë shënim.

2.3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT BERAT, KORÇE, ELBASAN .

janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar. Subjekti nuk ka rekomandim për përmirësimi në legjislationin.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve me karakter organizativ të lëna nga KLSH, u konstatua si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, rezulton se Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan nuk ka hartuar dhe dorëzuar raportimet 4 mujore të monitorimit të buxhetit, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në kundërshtim me nenin 65 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe.10-14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Titullari i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan dhe nëpunësi zbatues, në funksion edhe të planifikimit me eficiencë, të marrin masa për hartimin dhe dërgimin periodik të raporteve të zbatimit të buxhetit pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për të gjitha periudhat e raportimit që përcaktohet nga kuadri ligjor.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin, Bashkëlidhur Urdhëri.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

2.Gjetje nga auditimi : Nga auditimi në tërësi i listë-pagesave për gjithë periudhën rezultoi se ato janë të rregullta, plotësuar me të gjithë elementët dhe nënshkruhen nga Titullari i institucionit dhe Specialisti i Financës. Megjithatë listëpagesat nuk konfirmohen nga specialisti ose titullari i sektorit të Burimeve Njerëzore, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli III, pika 69. *(Më hollësisht trajtuar në pikën1, faqe.14-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandimi: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan dhe sektori i financës të marrin për konfirmim dhe nënshkrim nga sektori i burimeve njerëzore listë-pagesat.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin, ka kryer konfirmim dhe nënshkrim nga sektori i burimeve njerëzore listë-pagesat.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar

3.1.Gjetje nga auditimi : Nga shqyrtimi me përzgjedhje i ankesave të qytetarëve të mbërritura pranë Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan, rezulton se në të gjitha rastet, grupet e punës të ngritura nga titullari për trajtimin e ankesave, nuk mbajnë procesverbalet përkatëse pas çdo vizite në terren, ku të dokumentohet situata e konstatuar gjatë vizitës, adresimet në institucionet përkatëse për trajtimin e rasteve, si dhe dhënia e zgjidhjeve shteruese ndaj shqetësimit të paraqitur. Në praktikën e tyre të punës, grupet e ngritura nga titullari mbajnë procesverbale vetëm në rastet e shkeljeve ligjore për çështjet e mjedisit, për të cilat është kompetente vetë ARM, ndërkohë që në çdo rast tjetër, situata pasqyrohet vetëm në kthimin e përgjigjes së titullarit të ARM drejtuar qytetarit dhe mungon gjurma e auditimit për sa është konstatuar në terren nga grupi i punës apo mënyra si i është dhënë zgjidhje shqetësimeve. Po kështu, rezulton se grupet e punës nuk e ndjekin shqetësimin e bërë prezent deri në zgjidhjen e tij, duke u mjaftuar vetëm me këshillimin dhe kërkesën ndaj



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT BERAT, KORÇE, ELBASAN .

subjekteve private për marrjen e masave, por nuk vijohet me inspektime të tjera për të verifikuar nëse rekomandimet janë pëmbushur. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe.68-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan dhe grupet e punës të ngritura, për shqyrtimin e ankesave të marrin masa për dokumentimin e situatës së konstatuar në terren, komunikimeve me institucionet e përfshira dhe përgjigjet e tyre, si dhe ndjekjen e rekomandimeve për subjektet private.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin dhe nw cdo rast ka ngritur grupet e punës për shqyrtimin e ankesave.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar

4.Gjetje nga auditimi : Nga auditimi i ankesave dhe shqetësimeve të mbërritura në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan, mbi çështjet e ndotjes së mjedisit, rezulton se shqetësuese mbetet mungesa e laboratorit dhe pajisjeve të akredituara, për realizimin e matjeve dhe nxjerrjen e përfundimeve. Deri në momentin e auditimit, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk janë marrë masa për të dhënë një zgjidhje këtij problemi. Në pjesën më të madhe të ankesave, në mungesë të laboratorit dhe pajisjeve matëse të akredituara, ARM nuk është në gjendje të kthejë përgjigje qytetarëve nëse shqetësimi i tyre mbi nivelin e ndotjeve qëndron dhe rrjedhimisht të marrë edhe masat e nevojshme, siç përcaktohet në kuadrin ligjor që sanksionon veprimtarinë e saj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën,5 faqe. 68-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1.Rekomandimi: Drejtorët e Agjencive Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan, të propozojnë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për hartimin e metodologjisë së bashkëpunimi me institucione të tjera publike që kryejnë matje të niveleve të ndotjes në mjedis me pajisje të akredituara.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat/Elbasan/Korçë ka bashkëpunuar me studio të licensuara/akredituara për të bërë matjet e duhura për trajtimin e ankesave sipas natyrës së tyre. Bashkëngjitur praktika e ndjekur me subjektin AI. ku është bashkëpunuar me AKM – Prokuroria e Rrethit Elbasan dhe Kërkesa e subjektit për të marrë masa për kontraktimin e studios së licensuar/akredituar për matjet e nivelit të ndotjes.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nuk ka bazë të dhënash të subjekteve të pajisura me leje mjedisore, të ndara sipas tipit të tyre dhe ndikimeve që ato kanë në mjedis, mbi bazën e të cilave të hartojë programet vjetore dhe mujore të inspektimit bazuar mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut. në kundërshtim me ligjin nr. 10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” seksioni 2, nenet 62-66 “Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit”. Po ashtu, nuk ka metodologji konkrete për llogaritjen e riskut dhe frekuencën e inspektimit gjatë një vetite subjekteve që do të inspektohen *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe nr.50-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1.Rekomandimi: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan të marrë masa për krijimin dhe regjistrimin e të dhënave për subjektet e pajisura me leje mjedisore, të ndara sipas tipit të tyre dhe ndikimeve që ato kanë në mjedis.

Menjëherë dhe në vazhdimësi



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT BERAT, KORÇE, ELBASAN .

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat/Elbasan/Korçë ka marr masa dhe ka krijuar listën me të dhënat e subjekteve të pajisura me leje mjedisore dhe e përditëson atë vazhdimisht. Bashkëngjitur database i krijuar.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, programi vjetor i inspektimit për periudhën korrik 2020 dhjetor 2021, nuk është hartuar sipas përcaktimeve ligjore të bëra në shkronjat “a, c, ç dhe d” të pikës 2 të Urdhrit nr.5, datë 19.02.2015 “Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi programimin e inspektimeve”.

Gjithashtu programet mujore të inspektimit për periudhën korrik 2020 dhjetor 2021, nuk janë dërguar për mendim në Inspektoratin Qendror, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikën 2 të Kreut IV të VKM nr.696, datë 16.08.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të inspektoratit qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-inspektimi”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 57-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1.Rekomandimi: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat Korçë Elbasan në bashkëpunim, me sektorët e inspektimit, të marrë masa për subjektet e inspektuara, të bëjë një vlerësim të paraqitjes së tyre ndaj respektimit të kërkesave ligjore, ku në bazë të këtij vlerësimi të bëhet ndryshimi i kategorizimit të riskut të tyre (i lartë, i mesëm, i ulët), e për rrjedhojë edhe frekuenca e inspektimit të tyre, gjatë planifikimit të inspektimit.

6.2.Rekomandimi: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat Korçë Elbasan, me sektorët e inspektimit, të marrë masa që të gjitha programet mujore të inspektimit të përcillen për mendim pranë Inspektoratit Qendror

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin, është bërë planifikimi I inspektimeve në bazë risku.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe është zbatuar pjesërisht.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se mungonin relacionet dhe raportet e inspektimeve të kryera nga Sektorët e Mjedisit dhe Ujërave, pasi ato realizoheshin vetëm për nivelin faktik dhe jo të tabeluar dhe krahasuar me treguesit e parashikuar në planet vjetore, megjithëse planet vjetore mungonin. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë Elbasan të marrë masa që sektori i Mjedisit dhe Ujërave të hartojë raporte javore dhe mujore për njohjen e problematikave të subjekteve të inspektimit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. Programet mujore i përcillen Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe më pas është AKM e cila pasi e verifikon subjektet miraton listën me ndryshimet e nevojshme dhe ja përcjell për mendim Inspektoriatit Qendror. (Pjese e AKM)

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Në inspektimet e kryera në terren ,nga sektori i Ujërave, për plotësimin e procesverbalit të inspektimit nuk është i gjithë informacioni i nevojshëm duke u bazuar në kushtet



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT BERAT, KORÇE, ELBASAN .

e lejes mjedisore që disponon subjekti dhe zbatimin e secilit prej kushteve, si dhe të gjitha mangësitë e konstatuara nga ushtrimi i aktivitetit, sipas inspektimit në terren nga ana e inspektorëve, nuk ka përshkrime specifike mbi situatën konkrete në terren dhe mënyrën se si subjekti i zbaton kushtet e lejes mjedisore, konstatimet e inspektorëve janë të përgjithshme dhe për rrjedhim detyrat e lëna kufizohen në plotësim të dokumentacionit, si dhe kryerjen e dërgimin e vetë monitorimeve. Detyrat që lihen nuk janë të lidhura me konstatimet konkrete të situatës në terren të kryera nga specialistë të fushës së mjedisit, veprime në kundërshtim me ligjin nr.10433 datë 16.06.2011“Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” nenin 45-48,ku neni 45 (*Më hollësisht trajtuar në pikën5, faqe.55-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan,Spektori i Mjedisit dhe Ujërave pranë Agjencisë Rajonale të Mjedisit *Berat, Korçë, Elbasan* në çdo inspektim të kryer në terren të plotësoj sipas formatit procesverbalin e inspektimit.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. Bashkëlidhur raportimet javore dhe mujore të muajve Korrik-Gusht.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar

Menjëherë dhe në vazhdimësi

9. Gjetje nga auditimi Nga auditimi u konstatua se nga inspektimi i kryer nga sektori i ujërave në subjektet me aktivitet/veprimtari Hec, nuk është kërkuar nëse subjekte HEC apo Hidrocentrale kanë VNM, për ndikim në mjedis sipas ligjit 128/2020, për arsye se në listë verifikimin nuk ka përshkrim si dhe as bazë ligjore për këtë dokument (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe.50-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1.Rekomandimi Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan t’i kërkojë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Inspektoratit Qendrorë për ndërhyrjen në listë-verifikim për të shtuar një rubrikë, në të cilën të kërkohej dokumenti i Vlerësimit me Ndikim në Mjedis sipas përcaktimeve ligjore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. Bashkëlidhur procesverbalet me nr. AKM-BR-2023-000020-2 datë 23/06/2023.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

10.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Përgjegjësi i Sektorit të Mjedisit dhe Ujërave nuk ka hartuar dhe paraqitur periodikisht pranë Titullarit një raport mbi situatën dhe nivelin e realizimit të kushteve të lejeve të paplotësuara nga subjektet, për verifikimin e detyrave të lëna. Kjo do të shërbente Titullarit për nxjerrjen e autorizimeve për rishikim dhe detyrim deri në plotësimin e kushteve, (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe.51-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1.Rekomandimi: Përgjegjësit e Sektorit të Mjedisit dhe Sektorit të Ujërave , të marrin masa që në fund të çdo muaji të hartojnë dhe të paraqesin periodikisht pranë Titullarit një raport mbi situatën dhe nivelin e realizimit të kushteve të lejeve të paplotësuara nga subjektet, për verifikimin e detyrave të lëna.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin, ka bashkpunuar me AKM dhe IQ ndryshimet në listë-verifikim.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT BERAT, KORÇE, ELBASAN .

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, sektori i mjedisit nuk ka kryer verifikim në terren për subjekte, që kalojnë kapacitetet, nga lejet të Tipit C, në leje të Tipit B, pas ndryshimeve ligjore nr. 52/2020 “Për Lejet Mjedisore”. *Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe nr.53-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1. Rekomandimi: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë Elbasan, në bashkëpunim me Sektorin e Mjedisit të marrë masa për të kryer verifikimin në terren të subjekteve, që kalojnë kapacitetet për tu pajisur me leje mjedisore tu lihet detyrë të fillojnë procedurat për pajisjen me leje mjedisore në përputhje me kërkesat ligjore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin, janë përgartitur relacione nga grupet e punës për realizimin e kushteve të lejes sipas subjekteve.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se: në 5 raste në inspektimet e kryera nga inspektorët në procesverbal thuhet se: “subjekti u gjend i mbyllur”, ose nuk gjendet në adresën e dhënë. Inspektimet janë kryer në mungesë të përfaqësuesit të subjektit dhe nuk është lënë detyrë për paraqitje në ARM për marrje dijëni të problemeve të trajtuara,

- Nuk ka verifikime të dokumentuara në sistemin e QKL-së,
- Nuk ka dokumente për bashkëpunimin dhe rezultatet e tij me institucione të tjera. Veprime në kundërshtim me nenin Neni 36- Detyrimet e subjektit të inspektimit pika “d”; me ligjin nr. 10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” seksioni 2 neni 62-66 “Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit” si dhe me ligjin nr.10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” nenin 45-48,ku neni 45; nenin 11 “Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimi” të ligjit nr. 10431, datë 9.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe nr.57-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1.Rekomandimi:Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të marrë masa për hartimin e një regjistri me subjektet e konstatuara të mbyllura nga inspektimet dhe të konfirmojë statusin e gjendjes së regjistrimit, aktiv apo pasiv si biznes në QKB.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se formulari i Inspektimit, për paragrafin “I”, pika 3 “Të dhënat të përgjithshme të subjektit”, “Lloji i aktivitetit ekonomik” gjëndërohet nga sistemi dhe plotësohet me numër dhe jo me përshkrimin e aktivitetit në fjalë, gjë që e bën të pamundur të kuptohet lloji i aktivitetit që do të inspektohet kjo nga numri i lartë i aktiviteteve që operojnë në Qarkun e Berat, Korçë, Elbasan .(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe.57-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan të marrë masa, që në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror, të përmirësojnë formatin elektronik, “pikën 3 Lloji i aktivitetit”, të hiqet që të identifikohet saktë veprimtaria dhe aktiviteti i subjektit në rubrikën përkatëse.

Menjëherë dhe në vazhdimësi



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT BERAT, KORÇE, ELBASAN .

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat/Elbasan/Korçë për plotësimin e këtij rekomandimi i ka dërguar kërkesen AKM me Nr.927 Prot. Datë 01.09.2022.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

14.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në 16 raste është lënë detyrë të plotësojnë kërkesat ligjore, si në 7 raste që janë brenda afatit ligjore, ashtu edhe për 9 raste të cilave ju ka kaluar afati ligjorë për inspektim. Nga ana e Përgjegjësit të Sektorit të Mjedisit dhe Sektorit të Ujërave nuk është hartuar dhe paraqitur pranë Titullarit një raport mbi situatën dhe nivelin e realizimit të kushteve të lejeve, për verifikimin e detyrave të lëna. Mos plotësimi i dokumentacionit sipas përcaktimeve ligjore nga subjektet, është e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe.51-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: Përgjegjësit e Sektorit të Mjedisit dhe Ujërave në Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan, të marrin masa të përfshijnë në planet mujore të agjencisë kryerjen e inspektimeve të subjekteve që u është lënë detyrë plotësimi i kushteve të lejes

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin dhe ka hartuar planet mujore.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

15.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në 11 raste nga inspektorët nuk janë plotësuar listë verifikimet sipas nenit 39,41, të Ligji nr.10433 dt.16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", si dhe ligjit nr.52/2020 "Për Lejet e Mjedisit" shtojca 4.1 etj...sipas aktiviteteve që kryejnë subjektet. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe.51-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1. Rekomandimi: Inspektorët e Sektorit të Mjedisit dhe Sektorit të Ujërave, në Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan, të marrin masa që në çdo inspektim të plotësojnë të gjitha rubrikat që përmban listë-verifikimi për identifikimin e veprimtarisë që kryen subjekti sipas ligjit të sipërcituar.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. Në të gjitha inspektimet e kryera nga Inspektorët e Sektorit të Mjedisit dhe Sektorit të Ujërave janë plotësuar të gjitha rubrikat që përmban listë-verifikimi. Bashkëngjitur listë-verifikimi nga Sektori i Mjedisit me nr. AKM-BR-2023-000021-2/1 datë 22/06/2023 dhe listë-verifikimi nga Sektori i Ujërave me nr. AKM-BR-2023-000058-2/1 datë 03/08/2023.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

16.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, për periudhën korrik 2020- dhjetor 2021 në praktikat e dhënies së mendimit për VNM dhe mendim për Leje të Tipit A e B në dosjet përkatëse mungojnë dokumente mbështetëse, që dëshmojnë realizimin e procedurave si: akt-verifikime apo akt inspektive në terren, dokumente këto paraprake, mbi të cilat përgatitet shkresa për dhënie mendimi. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe.28-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1.Rekomandim: Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat, Korçë Elbasan, në praktikat e dhënies së mendimit për VNM apo mendime për Leje Mjedisore Tipi A/B, të bashkëlidhin dhe përfshijnë në dosje dokumente plotësuese dhe mbështetëse, që të vërtetojnë realizimin e procedurave në dhënien e mendimit.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT BERAT, KORÇE, ELBASAN .

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

17.Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat, Korçë Elbasan për periudhën korrik 2020- dhjetor 2021 ka dhënë mendime për VNM paraprahe/ të thelluar dhe për leje mjedisore të Tipit A, B, duke i përcjellë pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Si palë e përfshirë në proces, Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan nuk ka marrë informacione për vendimet e marra nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Qendra Kombëtare e Biznesit, veprime këto që janë në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe me nenin 11 të Ligjit Nr.10440 datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”. *Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe.27-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1. Rekomandim: Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan të kryejë korrespondencë zyrtare me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, për vendimet e marra për VNM paraprahe / të thelluar dhe me Qendrën Kombëtare të Biznesit për aplikimet për Leje mjedisore Tipi A/B dhe përditësimin në formë elektronike të regjistrit të lejeve të tipit A/ B dhe VNM-ve.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin.

Bashkëngjitur urdhëri i brendshëm i nxjerr nga Drejtori i ARM Berat/Elbasan/Korçë dhe databasë përkatës.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

18.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan, gjatë periudhës korrik 2020- dhjetor 2021, procedurën e dëgjësës me publikun për lejet mjedisore Tipi A / B, i ka realizuar në një afat të shkurtër kohor (5-7 ditë) nga delegimi i dëgjësës nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit . *(Më hollësisht trajtuar në pikën4.1, faqe.35-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1.Rekomandimi: Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan të marrë masa që njoftimi i dëgjësës me publikun të qëndrojë i publikuar në faqen e web-it, për një afat 15 ditor, me qëllim sensibilizimin dhe informimin sa më shumë pjesëmarrësve në takim.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në 26 subjekte që ushtrojnë aktivitet, për nxjerrjen e mineraleve rërës dhe argjilës, nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur, nuk ka dokumentacion mbi Zërat Kadastra le të sipërfaqeve ku zhvillohet ky aktivitet, nqs janë apo jo pjesë e fondit pyjor kullësor që duhet hequr nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore në momentin e pajisjes me leje shfrytëzimi. Veprim në kundërshtim me VKM-së, nr.391 datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” pika 8 i cili përcakton: “8.Për shpërblimin e dëmeve të shkaktuara në fondin pyjor zbatohen tarifave të përcaktuara në lidhjen 8, të shtojcës, që i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT BERAT, KORÇE, ELBASAN .

bashkëlidhet këtij vendimi ”Lidhja 8 “Tarifat e shpërblimit të dëmeve të shkaktuara në fondin pyjor” pika 1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe.58-59, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1. Rekomandimi: Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan të marrë masa që në bashkëpunim me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të përcaktojnë sipërfaqet janë apo jo pjesë e fondit pyjor kullor ku zhvillojnë aktivitet subjektet për nxjerrjen e mineraleve për të konstatuar dhe evidentuar situatën e gjendjes së mjedisit, ekzaminimin e dëmtimeve në mjedis të shkaktuar nga aktiviteti i tyre si dhe në raste kur ka shkelje të bëhet përcaktimi i vlerës së dëmit dhe kërkimin e rehabilitimit të këtyre parcelave në përputhje me planet e mbarështimit të pyjeve të NJQV-ve.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

C. TË ARDHURA TË MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan, për 12 subjekte të cilat nuk kanë dorëzuar raportet e monitorimin/vete monitorimit mjedisor si dhe dokumentacion ligjore, në 10 raste me vlere gjobe 3000 mije lekë, si dhe 2 raste në vlere 2,000 mijë lekë, nuk është aplikuar masa administrative në vlerën totale prej 3,000+2,000= **5.000 mijë lekë**, veprim në kundërshtim me nenin 29 pika b (ii) të ligjit nr. 10488/2014 “Për lejet e mjedisit” (Trajtuar më hollësisht në pikën 5 në faqet 59-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandim: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan të marrë masa për ushtrimin e kontrollit në 12 subjekte mbi plotësimin e raporteve të monitorimit mjedisor si dhe dokumentacion ligjore dhe për rastet e konstatuara me shkelje të aplikojë masa administrative me gjobë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

Për përmirësimin e punës në të ardhmen, rekomandojmë

A. MASA ORGANIZATIVE

Nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën me shkresën, përcjellëse nr. 368/8 prot, datë 30.09.2022, ka dërguar Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan, të Auditimit së bashku me rekomandimet përkatëse si vijon:

9. Gjetje nga auditimi Nga auditimi u konstatua se nga inspektimi i kryer nga sektori i ujërave në subjektet me aktivitet/veprimtari Hec, nuk është kërkuar nëse subjekte HEC apo Hidrocentrale kanë VNM, për ndikim në mjedis sipas ligjit 128/2020, për arsye se në listë verifikimin nuk ka përkrahim si dhe as bazë ligjore për këtë dokument. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 7-7 të Raportit të Auditimit).

9.1.Rekomandimi Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan t’i kërkojë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Inspektoratit Qendrorë për ndërhyrjen në listë-verifikim për të shtuar një rubrikë, në të cilën të kërkohej dokumenti i Vlerësimit me Ndikim në Mjedis sipas përcaktimeve ligjore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT BERAT, KORÇE, ELBASAN .

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se: në 5 raste në inspektimet e kryera nga inspektorët në procesverbal thuhet se: “subjekti u gjend i mbyllur”, ose nuk gjendet në adresën e dhënë. Inspektimet janë kryer në mungesë të përfaqësuesit të subjektit dhe nuk është lënë detyrë për paraqitje në ARM për marrje dijeni të problemeve të trajtuara,

- Nuk ka verifikime të dokumentuara në sistemin e QKL-së,

- Nuk ka dokumente për bashkëpunimin dhe rezultatet e tij me institucione të tjera. Veprime në kundërshtim me nenin Neni 36- Detyrimet e subjektit të inspektimit pika “d”; me ligjin nr. 10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” seksioni 2 neni 62-66 “Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit” si dhe me ligjin nr.10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” nenin 45-48,ku neni 45; neni 11 “Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimi” të ligjit nr. 10431, datë 9.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 7-7 të Raportit të Auditimit).

12.1.Rekomandimi:Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të marrë masa për hartimin e një regjistri me subjektet e konstatuara të mbyllura nga inspektimet dhe të konfirmojë statusin e gjendjes së regjistrimit, aktiv apo pasiv si biznes në QKB.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se formulari i Inspektimit, për paragrafin “I”, pika 3 “Të dhënat të përgjithshme të subjektit”, “Lloji i aktivitetit ekonomik” gjëndërohet nga sistemi dhe plotësohet me numër dhe jo me përshkrimin e aktivitetit në fjalë, gjë që e bën të pamundur të kuptohet lloji i aktivitetit që do të inspektohet kjo nga numri i lartë i aktiviteteve që operojnë në Qarkun e Berat, Korçë, Elbasan . (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 7-8 të Raportit të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan të marrë masa, që në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror, të përmirësojnë formatin elektronik, “pikën 3 Lloji i aktivitetit”, të hiqet që të identifikohet saktë veprimtaria dhe aktiviteti i subjektit në rubrikën përkatëse.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

16.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, për periudhën korrik 2020- dhjetor 2021 në praktikat e dhënies së mendimit për VNM dhe mendim për Leje të Tipit A e B në dosjet përkatëse mungojnë dokumente mbështetëse, që dëshmojnë realizimin e procedurave si: akt-verifikime apo akt inspektime në terren, dokumente këto paraprake, mbi të cilat përgatitet shkresa për dhënie mendimi. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 8-8 të Projekt -Raportit të Auditimit).

16.1.Rekomandim: Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat, Korçë Elbasan, në praktikat e dhënies së mendimit për VNM apo mendime për Leje Mjedisore Tipi A/B, të bashkëlidhin dhe përfshijnë në dosje dokumente plotësuese dhe mbështetëse, që të vërtetojnë realizimin e procedurave në dhënie mendimi.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në 26 subjekte që ushtrojnë aktivitet, për nxjerrjen e mineraleve rërës dhe argjilës, nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur, nuk ka dokumentacion mbi Zërat Kadastra le të sipërfaqeve ku zhvillohet ky aktivitet, nqs janë apo jo pjesë e fondit pyjor kullësor që duhet hequr nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore në momentin e pajisjes me leje shfrytëzimi. Veprim në kundërshtim me VKM-së, nr.391 datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” pika 8 i cili përcakton: “8.Për shpërblimin e dëmeve të shkaktuara në fondin pyjor zbatohen tarifat e përcaktuara në lidhjen 8, të shtojcës, që i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT BERAT, KORÇE ,ELBASAN .

bashkëlidhet këtij vendimi ”Lidhja 8 “Tarifat e shpërblimit të dëmeve të shkaktuara në fondin pyjor” pika 1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 8-8 të Raportit të Auditimit).

19.1. Rekomandimi: Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan të marrë masa që në bashkëpunim me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të përcaktojnë sipërfaqet janë apo jo pjesë e fondit pyjor kullor ku zhvillojnë aktivitet subjektet për nxjerrjen e mineraleve për të konstatuar dhe evidentuar situatën e gjendjes së mjedisit, ekzaminimin e dëmtimeve në mjedis të shkaktuar nga aktiviteti i tyre si dhe në raste kur ka shkelje të bëhet përcaktimi i vlerës së dëmit dhe kërkimin e rehabilitimit të këtyre parcelave në përputhje me planet e mbarështimit të pyjeve të NJQV-ve.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

B. TË ARDHURA TË MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat, Korçë, Elbasan, për 12 subjekte të cilat nuk kanë dorëzuar raportet e monitorimin/vete monitorimit mjedisor si dhe dokumentacion ligjore, ne 10 raste me vlere gjobe 3000 mije lekë, si dhe 2 raste në vlere 2,000 mijë lekë, nuk është aplikuar masa administrative në vlerën totale prej 3,000+2,000= **5.000 mijë lekë**, veprim në kundërshtim me nenin 29 pika b (ii) të ligjit nr. 10488/2014 “Për lejet e mjedisit” . (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet 8-9 të Projekt -Raportit të Auditimit).

1.1.Rekomandim: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat,Korçë, Elbasan të marrë masë për ushtrimin e kontrollit në 12 subjekte mbi plotësimin e raporteve të monitorimit mjedisor si dhe dokumentacion ligjore dhe për rastet e konstatuara me shkelje të aplikojë masa administrative me gjobë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi

GRUPI I AUDITIMIT

1. V. B., Përgjegjës Grupi
2. Sh. H. , auditues

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

A. Z.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022 NË AGJENCIA KOMBËTARE E PYJEVE TIRANË”

RAPORT PËRFUNDIMTARË I AUDITIMIT TEMATIK

“PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA”

SUBJEKTI

AGJENCIA KOMBËTARE E PYJEVE TIRANË

	Përmbajtja	1-1
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	2-2
	1.Përshkrim i shkurtër Projektit të Auditimit	2-2
	2.Përshkrim i gjetjeve kryesore	2-3
	3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	4-4
II	HYRJE	4-4
	2. Qëllimi	4-4
	3. Identifikimi i çështjes	5-5
	4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	5-5
	5. Përgjegjësitë e audituesve	5-5
	6. Kriteret e vlerësimit	5-5
	7. Standardet e Auditimit	5-5
	8. Metodatat e auditimit	5-5
	9. Dokumentimi i auditimit	5-6
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	6-7
1	Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	6-6
2	Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit	6-6
2.1	Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".	7-7
2.2	Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.	7-7
2.3	Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht,sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	7-7
2.4	Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.	7-7
IV.	Gjetje dhe Rekomandime	7-10



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022 NË AGJENCIA KOMBËTARE E PYJEVE TIRANË”

I. Përmbledhje Ekzekutive

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (në vijim KLSH) ushtroi auditimin tematik me objekt “Mbi nivelin e zbatimit të të rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022” Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me verifikimin dhe vlerësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Gjatë auditimit në terren nga grupi i auditimit është mbajtur 1 akt-verifikim, sipas çështjeve respektive, i cili është dorëzuar në protokollin e subjektit. Në përfundim të punës në terren është kryer takimi përmbyllës me përfaqësuesit e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve Tiranë.

I.2. Në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet më të rëndësishme të auditimit, paraqiten si më poshtë vijon:

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor (RKFP) nuk është i plotë, pasi në këtë fond pyjor nuk janë të pasqyruara ato sipërfaqe pyjorë të cilat i kanë kaluar në pronësi Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet VKM-së Nr. 707, datë 21.11.2018 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin të disa pronave të paluajtshme shtetërore, në vijën bregdetare Shkodër-Fier”. Sipas nenit 2 të ligjit nr.57/2020 “Për pyjet”, ligji i shtrin efektet për çdo sipërfaqe pyjore pavarësisht pronësisë, për sa kohë plotësohet kushti i përkufizimit të “pyllit”, pavarësisht administrimit qoftë privat apo publik.	7	E LARTË	Agjencia Kombëtare e Pyjeve të marrë masa për përditësimin e regjistrit kombëtar të fondit pyjor me sipërfaqet që i kanë kaluar në administrim Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.
2.	Në lidhje me procesin inventarizimit të fondit pyjor konstatohet se inventari i fundit i përket vitit 2018 e për rrjedhojë rezulton se nuk ka nisur ciklin e radhës 8 vjeçar i riinventarizimit kombëtar të pyjeve, duke inventarizuar 25% çdo 2 vjet të fondit pyjor, në kundërshtim me nenin 6 të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet. Nga krahasimi i inventarëve 2003-	7	E MESME	Agjencia Kombëtare e Pyjeve të marrë masa që të nisë procesin e inventarizimit të fondit pyjor, duke parashikuar në buxhetin e vitit 2023 të gjitha kostot e mundshme, përfshirë ngritjen e agjencive rajonale të pyjeve, për përfundimin e procesit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022 NË AGJENCIA KOMBËTARE E PYJEVE TIRANË”

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	2018, nga vëllimi total drunor, është hequr për 15 vjet një vëllim prej 32.9 mln m ³ (përfshi materialin drusor të djegur nga zjarret në pyll), pra 2.2 mln/m3/vit, ose dyfishin e mundësisë vjetore të shfrytëzimit.			
3.	Me vendimet e Komitetit të Investimeve Strategjike lihen detyra për heqjen nga fondi pyjor para marrjes në përdorim të sipërfaqes përkatëse apo ngarkimin e AKP-së me saktësimin e koordinatave apo verifikime të pronës. Po ashtu, kërkohet çregjistrimi nga kadastra dhe fondi pyjor, shoqëruar me detyrimin e subjektit përfitues që të paguajë vlerat përkatëse të pakësimit të volumit të lëndës drusore, të sipërfaqes që do të hiqet nga fondi pyjor si dhe pyllëzimin e një sipërfaqeje tjetër. Për këto detyra, rezulton se Agjencia Kombëtare e Pyjeve gjendet e përjashtuar nga këto procese, së pari ende nuk administron në mënyrë të plotë fondin pyjor, së dyti rezulton e përjashtuar nga proceset e kadastrës pyjore, sa i përket çregjistrimit, heqjes nga fondi pyjor dhe zëvendësimit, pasi kjo agjenci nuk harton/miraton asnjë akt administrativ mbi këto çështje dhe nuk informohet nga MTM mbi vendimet e Këshillit të Ministrave për heqjen nga fondi pyjor.			Agjencia Kombëtare e Pyjeve të marrë masa që procedurat për heqjen nga regjistri i fondi pyjor të sipërfaqeve që preken nga investimet strategjike, t'i nisë vetëm pas administrimit të projekteve për zëvendësimin e këtyre sipërfaqeve dhe marrjes së konfirmimit nga MTM për nxjerrjen e akteve(VKM apo Ligji) për heqjen nga fondi pyjor.
4.	Agjencia Kombëtare e Pyjeve (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme) në 4 raste, për shumën 44,419 lekë , sipas urdhër shpenzimeve nr.19 datë 04.03.2021, nr. 17, datë			Agjencia Kombëtare e Pyjeve (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të përcaktojë përgjegjësitë lidhur me gjobat e paguara sipas urdhër shpenzimeve nr. 19, datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022 NË AGJENCIA KOMBËTARE E PYJEVE TIRANË”

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<p>25.02.2021, nr. 45, datë 15.04.2022, nr. 27, datë 02.03.2022, ka likuiduar DRSHTRR Tiranë për pagesa gjobash për vonesa, brenda vlerës së përgjithshme, sipas dokumenteve për taksa makine, <i>gjopa për te cilat duhej të nxirrej përgjegjësia dhe të paguheshin prej personave përgjegjës,</i> për rrjedhojë nuk duhej të paguhej shuma prej 44,419 lekë nga AKP.</p> <p>-Sa sipër bie në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.</p>			<p>04.03.2021, nr. 17, datë 25.02.2021, nr. 45, datë 15.04.2022, nr. 27, datë 02.03.2022 dhe më pas të ndjekë gjithë rrugët ligjore për arkëtimin e shumës 44,419 lekë sipas dokumenteve për taksa makine, prej përfituesit në të kundërt shuma të zhdëmtohet nga personat përgjegjës.</p>

I.3. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Mbështetur në standardet e INTOSAI-t, Manualit të Përputhshmërisë, Manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, nga auditimi tematik i kryer në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, rezultoi se niveli i zbatimit të rekomandimeve plotësisht, është në nivelin 70%. Rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm janë pranuar plotësisht, ku për përmirësimin e gjendjes janë lënë 23 gjithsej, nga këto 21 masa organizative, 1 masa me 3E, 1 shpërblim dëmi. nga të cilat 13 janë zbatuar, 5 masë pjesërisht dhe 3 masa nuk janë zbatuar. 1 masë me efekt financiar zbatuar, 1-masë për shpërblim dëmi pa zbatuar.

I. HYRJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Agjencinë Kombëtare të Pyjeve Tiranë, “Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara për periudhën 2022-2023”, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me: verifikimin e respektimit të afatit 20-ditor dhe 6-mujor për kthim përgjigje mbi përgatitjen e plan-veprimit dhe informacionin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve; verifikimin e nivelit të zbatimit të masave për përmirësim ligjor, organizative dhe të ardhura të munguara.

Sipas Programit të Auditimit, nr. 656 datë 17.07.2023, auditimi u krye nga grupi auditues, si vijon:

1. V. B., Përgjegjës Grupi
2. Sh. H., auditues

1. Objektivat e auditimit

Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme, procedurave për ndjekjen dhe dokumentimin e zbatimit të tyre, mbi zbatimin e afatit 20 ditor dhe 6 mujor të kthimit të përgjigjes, si dhe mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e zbatimit të rekomandimeve.

2. Qëllimi i auditimit

Të vlerësojë dhe evidentojë masat e marra nga subjektet përkatëse për zbatimin e rekomandimeve, hartimin e matricave (plan veprimi ose masash) për zbatimin e rekomandimeve. Të vlerësojë aktet



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022 NË AGJENCIA KOMBËTARE E PYJEVE TIRANË”

administrative përkatëse (urdhurat) të nxjerra për zbatimin e rekomandimeve. Të vlerësojë dokumentacionin që shoqëron dhe vërteton zbatimin e rekomandimeve, si dhe të verifikojë nxjerrjen e vendimeve për fillimin e procedurave administrative për dhënien e masave disiplinore dhe pasqyrimin në dosjen personale të punonjësve. Të verifikojë dhe dokumentojë me kujdes nëse janë ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ato ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin e shpërblimit të dëmit ekonomik ose gjobave të vendosura.

3. Identifikimi i çështjes

Projekt Raporti i Auditimit synon të identifikojë përbushjen e rolit të strukturave të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve Tiranë dhe përgjegjësi, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve Tiranë, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e objektiv e profesional mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI.

6. Kriteret e vlerësimit

Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikën, është pasur si kriter vlerësues në radhë të parë:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Rregullorja e Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, e ndryshuar me Vendimin nr.107, datë 08.09.2017 të Kryetarit Të KLSH-së.
- Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe regjistri elektronik institucional, miratuar me Vendimin nr.67, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së.

7. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar, si rrjedhojë edhe Projekt Raporti i Auditimit është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, Rregullores së Procedurave të Auditimit, Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

8. Metodologjia e auditimit

1. Auditim i plotë sipas cilësimeve të bëra në drejtimet e auditimit.
2. Verifikimi i Urdhrëve, Udhëzimeve dhe çdo dokumenti ligjor të nevojshëm për zbatimin e rekomandimeve.

9. Dokumentimi i auditimit

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, shqyrtimit të komenteve dhe



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022 NË AGJENCIA KOMBËTARE E PYJEVE TIRANË”

shpjegimeve të subjektit të audituar është përgatitur Projektraporti i Auditimit, i cili do të jetë materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit për ridërgimin e rekomandimeve.

III. PËRSHKRIMI I I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Agjencisë Kombëtare të Pyjeve Tiranë, është e organizuar dhe funksionon në bazë VKM –së, nr. 570 datë. 17.07.2019 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve” ngarkojnë Agjencinë Kombëtare të Pyjeve për vlerësimin e gjendjes së pyjeve”, si dhe me Urdhrin nr.24, të Kryeministrit, datë 03.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve”;

Ligji. “Për Pyjet” Nr. 57/2020 datë 30.04.2020.

2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

1. Hartimi i plan-veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 gërma (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi u konstatua se:

- Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 891/6 prot, datë 18.01.2023 ka dërguar në Agjencisë Kombëtare të Pyjeve Tiranë, Raportin Përfundimtar të Auditimit së bashku me rekomandimet përkatëse.

- Nga Agjencisë Kombëtare të Pyjeve Tiranë janë marrë masa për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH duke hartuar plan veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve (njoftuar KLSH me shkresë nr.prot.50/1 datë 27.02.2023) të lëna nga KLSH. Sipas plan veprimit dhe urdhërave përkatës janë caktuar strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve, afatet për zbatimin e tyre, si dhe treguesi i rezultateve të arritura, në përputhje me Ligjin nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 15, gërma j. Me shkresë nr.941 prot., datë 15.07,2022 nga ana e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve Tiranë është kthyer përgjigje brenda 20 ditëve për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 gërma (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

- Nga ana e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve Tiranë me shkresën përcjellëse. Me shkresë nr.50/2 prot., datë 29,06.2023 është përcjellë relacioni për zbatueshmërinë e rekomandimeve të lëna nga KLSH, janë marrë masa për respektimin e afatit prej 6 (gjashtë) muajsh për raportimin në KLSH me anë të një informacioni të hollësishëm për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim me Ligjin nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 30, pika 2.

Niveli i pranimit dhe statusi sipas llojit të rekomandimit në numër dhe në vlerë

Nga ana e KLSH janë lënë **23 rekomandime** gjithsej, nga këto:

- **21 masa organizative**, nga të cilat 13 janë zbatuar, 5 masë pjesërisht dhe 3 masa nuk janë zbatuar.
- **1 masë me efekt financiar** zbatuar.
- **1-masë për shpërblim dëmi pa zbatuar.**

Pasqyra e realizimit të detyrave të rekomanduara paraqitet si me poshtë:

Nr	Emërtimi	Rekomandimet në numër :	Nga rekomandimet gjithsej: Sa me dëme ekonomike
----	----------	-------------------------	---



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022 NË AGJENCIA KOMBËTARE E PYJEVE TIRANË”

	Rekomandim gjithsej	Nga rekomandimet janë:			Rekomanduar Gjithsej		Nga rekomandimet janë:						
		Zbatuar	Pjesërisht	Pa zbatuar	Nr. per	Në mijë/lek	Zbatuar arkëtuar		Zbatuar pjesërisht		Pa zbatuar		
							Nr. per	Në mijë/lek	Nr. Pers	Në mijë/lek	Nr. pers	Në mijë/lek	
1.	Masa organizative	21	14	4	3	0	0	0	0	0	0	0	0
2.	Masa për përmirësim ligjor	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3.	Shpërblim demi	1	0	0	1	0	0	1	0	0	0	0	44,419
4.	Masa efekt financiar	1	1	0	0	1	0	0	0	0	0	1	0
	Totali	23	15	4	4	1	0	0	0	0	0	0	44,419

2.2. Zbatimi i rekomandimeve për përmirësim në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar. Subjekti nuk ka rekomandim për përmirësimi në legjislacionin.

Duke qenë se nga auditimi i mëparshëm i KLSH nuk janë lënë rekomandime për përmirësim ligjorë atëherë kjo pikë e programit ezaurohet me këtë shënim.

2.3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Agjencia Kombëtare e Pyjeve

Për sa është trajtuar në këtë Projekt Raport të Auditimit, nga subjekti i audituar, përkatësisht bashkia AKP me Drejtor A.K., me shkresën e administruar në KLSH me nr.50/60, prot.639/9, datë 06.11.2023,.

Pretendimi i subjektit:

-Lidhur me Akt verifikimin nr.4 të mbajtur nga KLSH, Departamenti i Auditimit të Performancës nga ana e subjektit AKP, është dërguar observacion ku është bashkëlidhur shkresa përcjellëse, më disa dukomunta fotokopje.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Në lidhje me sa më sipër observacioni i paraqitur merret në konsideratë pjesërisht dhe është reflektuar në raport përfundimtar.*

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

A. MASA ORGANIZATIVE

Nga auditimi i mëparshëm Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 891/6 prot, datë 18.01.2023 ka dërguar në Agjencisë Kombëtare të Pyjeve Tiranë Raportin Përfundimtar të Auditimit së bashku me rekomandimet përkatëse si vijon:

Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), për të 3 vitet 2020, 2021, 2022, referuar ligjeve “Për buxhetin e vitit 2020, 2021, 2022”, të ndryshuar, nga ana e këtij institucioni është dërguar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022 NË AGJENCIA KOMBËTARE E PYJEVE TIRANË”

kërkesa nr. 49, datë 21.09.2020, ku paraqitet gjendja financiare dhe fakti i mungesës së buxhetit, si rrjedhje pamundësia e përmbushjes së detyrave të caktuara më aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Për vitin 2021, sipas tabelës së paraqitur rezulton se buxheti i vitit 2021 është realizuar në masë 94 %, pra me mosrealizim, dhe në vlerë absolute me një vlerë prej 3,080,225 lekë diferencë e parealizuar.

Mosrealizimet e rezultuara, tregojnë në mënyrë eksplicite faktin se sa i shkëputur ka qenë procesi i hartimit të planit nga situata dhe nevojat faktike, sidomos për mirëmbajtjen a automjeteve, të pajisjeve të zyrave, deri tek zëri “Shpenzime për të tjera materiale dhe shërbime”.

1.1. Rekomandim: (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për të ardhmen, të argumentojë kërkesat për fonde me vërtetësi dhe realizëm, duke shmangur si keqpërdorimin e fondeve në rastin e planifikimit të fryrë, ashtu edhe mosrealizimin e detyrave ligjore operative të institucionit në funksion të ligjit, me qëllim rritjen e performancës në aktivitetin e tij.

Në vijimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. *Agjencia Kombëtare e Pyjeve, ka marrë masa që kërkesat buxhetore në vijim të planifikohen mbështetur në nevojat reale të AKP-së të argumentuara, të planifikuara sipas plan programeve vjetore të drejtorive teknike bazuar në Udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018 “Për Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”.*

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

2. Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), për të 3 vitet 2020, 2021, 2022, *nuk ishin hapur ditarët e analitikë dhe pasqyrat financiare të viteve 2020 dhe 2021 ishin përgatitur nga jashtë (extra kontabël).*

-mungonin dhe nuk kryheshin veprime kontabël në ditarët e bankës, magazinës, të ardhurave dhe shpenzimeve, ditarin e veprimeve të ndryshme, ditari i pagave, dhe të gjithë ditarët e tjerë, analizat, centralizatori / libri i madh, *në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 15, dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 28.si dhe llogaritë 214,215 218, në regjistër të aktiveve, veprime në kundërshtim me pikën 30, të Udhëzim-it të Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.11.2011. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet 40-46 të Raportit përfundimtarë të Auditimit).*

2.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për hartimin e ditarëve analitikë të bankës, magazinës, të ardhurave dhe shpenzimeve, ditarin e veprimeve të ndryshme, ditari i pagave, dhe të gjithë ditarët e tjerë, centralizatori/libri i madh, etj., si dhe mbi bazën e këtyre të përgatisë pasqyrat financiare të vitit 2022. Të saktësohen vlerat dhe të kryhen ndryshimet e nevojshme, në pasqyrat financiare të vitit 2022. Të përgatiten inventarët dhe analizat sipas posteve të bilancit si dhe të krijohet e të mbahet regjistri i aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv.

Në pasqyrat financiare 2022 dhe në vijimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. Agjencia Kombëtare e Pyjeve ka marrë masa që pasqyrat financiare të vitit 2022, të përgatiten mbi bazën e dokumenteve financiar, rakordimeve me thesarin, ditarëve analitikë të bankës dhe kontabilizimit të veprimeve ekonomike, mbylljeve të llogarive vjetore të buxhetit, bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022 NË AGJENCIA KOMBËTARE E PYJEVE TIRANË”

Ekonomisë nr.34, datë 14.12.2022 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2022”, Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” si dhe në Udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, të cilat janë dorëzuar brenda afatit ligjor në Degën e Thesarit Tiranë dhe në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit me shkresën nr. 277 prot, datë 30.03.2023. Gjithashtu, Regjistri i aktiveve është përgatitur sipas përcaktimeve në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, me të gjitha elementët/informacionin që zotërojmë për aktivet që kemi marrë me transferim kapitali pa pagesë nga ish-ISHMPUT, AKM dhe MTM prej fillimit të krijimit të AKP-së. Është realizuar inventarizimi i përgjithshëm i mjeteve kryesore dhe inventarit të imët për vitin 2022 protokolluar me nr. 1161/1 prot, datë 10.01.2023 dhe Raporti mbi inventarizimin e përgjithshëm protokolluar me nr. 1161/2 prot, datë 10.01.2023 nga komisioni i inventarizimit në zbatim të Urdhrit nr. 61, datë 30.12.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm, ku rezultatet e saj kanë shërbyer për përgatitjen e Pasqyrës së Pozicionit Financiar (Bilancit) të vitit 2022.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

3. Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), për vitet 2020-2021, në paraqitjen e llogarive të amortizimit në pasqyrat financiare, *nuk paraqiten shumat e amortizimit të akumuluar 219, 681 “Kuotat e amortizimit të AAGJ, të shfrytëzimit” nuk është plotësuar me amortizimin vjetor (Kosto historike minus amortizimin e akumuluar), veprim ky moszbatim të me Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2019, Kapitulli III, pika 31.(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet 40-46 të Raportit përfundimtarë të Auditimit).*

3.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa në paraqitjen e llogarive të amortizimit në pasqyrat financiare, të evidentojë shumat e akumuluar të amortizimit, në llogaritë 209 dhe 219, llogarinë 1013, llogarinë nr. 681 dhe të saktësojë shumat vjetore të amortizimit të AAGJ.

Në pasqyrat financiare 2022 dhe në vijimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. Pasqyrat Financiare Vjetore të vitit 2020, 2021 dhe 2022 janë përgatitur bazuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme. Për sa më sipër, në Pasqyrat Financiare Aktivet Afatgjata janë paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar në zërat përkatës, me vlerën e tyre Neto (Kosto historike – Amortizimin e Akumuluar), ndërsa shpenzimet e amortizimit të AAGJ janë paraqitur në zë më vete në formatin e Pasqyrës së Performancës Financiare. Gjithashtu, lidhur me informacionin për Aktivet AGJ të institucionit në formatin nr. 7/a – Gjendja dhe ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Kosto Historike), janë pasqyruar aktivet afatgjata të institucionit në zërat përkatës me vlerën e kostos historike, dhe në formatin nr. 7/b – Gjendja dhe ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Vlera Neto), janë pasqyruar aktivet afatgjata të institucionit në zërat përkatës, te njëra kolonë me koston e tyre historike, te kolona tjetër amortizimi i akumuluar dhe në fund vlera e tyre neto në mbyllje të vitit ushtrimor 2022, ku përkon dhe me vlerat e pasqyruara në Pasqyrën e Pozicionit Financiar.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022 NË AGJENCIA KOMBËTARE E PYJEVE TIRANË”

4. Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), lidhur me shënimet shpjeguese (Pasqyra F5) *nuk ishin plotësuar me të gjitha ekstremet rubrikat si më poshtë:*

Rubrika 1 Rubrika 2: pasqyrave financiare.

Sa sipër bie në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 03.09.2019, pika 3.7 “Rregullat për dhënien e shpjegimeve për pasqyrat financiare individuale”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet 27-40 të Raportit përfundimtarë të Auditimit).

4.1.Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për të plotësuar me të gjitha ekstremet rubrikat 1 dhe 2, në pasqyrat financiare (Pasqyra F5).

Në pasqyrat financiare 2023 dhe në vijimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. Agjencia Kombëtare e Pyjeve ka marrë masa që pasqyrat financiare të vitit 2022, specifikisht formati nr.5 “Shënimet Shpjeguese” për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të AKP, të plotësohet me të gjitha informacionet e kërkuara përkatësisht në rubrikat 1 dhe 2, sipas formatit të miratuar në Udhëzimet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të cilat janë dorëzuar bashkë me pasqyrat e tjera financiare brenda afatit në Degën e Thesarit Tiranë dhe në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit me shkresën nr. 277 prot, datë 30.03.2023.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

Në pasqyrat financiare 2023 dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), lidhur me plotësimin e llogarive të aktiveve afatgjatë dhe rakordimin me inventarët kontabël dhe fizikë, kishte plotësuar llogarinë sintetike 215 “Mjete Transporti” për shumën me vlerë të mbetur 9,750,526 lekë e cila nuk përputhet me vlerën e 5 automjeteve deri më datë 31.12.2021, të cilat janë bërë hyrje me vlerë fillestare 19,529,571 lekë dhe **në vlerë neto 6,550,526 lekë.**

Vlera e mësipërme nuk rakordon me vlerën e bilancit për mjetet e transportit prej 9,750,526 lekë me një diferencë më pak prej 3,200,250 lekë.

Theksojmë se inventari bashkëlidhur pasqyrave financiare është paraqitur kontabël por edhe fizik, në një kohë që në inventarin fizik të komisionit të inventarizimit nuk është paraqitur automjeti copë 1 x 3,250,250.

Diferenca ka ardhur për shkak se në inventarin bashkëlidhur pasqyrave financiare, inventar kontabël dhe fizik, është përfshirë edhe vlera e automjetit . Në mungesë të ditarit analitik edhe për vitin 2022, nuk mund të verifikohet kontabilizimi i kryer nga financa. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet 46-54. të Raportit përfundimtarë të Auditimit).

5.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa dhe të bëjë korrigjimin në pasqyrat financiare të vitit 2022, lidhur me llogarinë sintetike 215 “Mjete Transporti”, duke shtuar në këto pasqyra vlerën e automjetit Chevrolet fuoristradë Targë SH 5675 E, copë 1 x 3,250,250= **3,200,250 lekë.**

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. Agjencia Kombëtare e Pyjeve ka marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2022, specifikisht në Pasqyrën e Pozicionit Financiar është shtuar vlera e automjetit tip Chevrolet Fuoristradë, me targë AB ... GB (targa e vjetër SH 5675



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022 NË AGJENCIA KOMBËTARE E PYJEVE TIRANË"

E), copë 1 x 3,250,250 = 3,200,250 lekë, e cila është bërë hyrje në magazinë me Fletë - Hyrjen nr. 01 datë 02.02.2022.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar

6. Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), lidhur me veprimet e kryera nëpërmjet bankës, në 4 raste të shërbimeve të kryera automjeteve, nga ana e Sektorit të Financës nuk është aplikuar administrimi i pjesëve të vjetra, në 1 rast, Shërbim riparim automjeti, 36,000 lekë pjesëve të këmbimit, të cilat duheshin bërë hyrje në magazinë të veçantë (rikupero). (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet 46-54 të Raportit përfundimtarë të Auditimit).

6.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa dhe të krijojë magazinë rikupero lidhur me administrimin e pjesëve të vjetra të automjeteve në rastet e shërbimeve të kryera dhe trajtimin e mëtejshëm të tyre.

Në vijimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. Agjencia Kombëtare e Pyjeve është duke marrë masa për krijimin e një magazinë rikupero me pjesët e vjetra të automjeteve në rastet e shërbimeve të kryera.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se titullari i institucionit nuk ka nxjerrë urdhër për krijimin e komisioneve për procesin e vlerësimit të aktiveve dhe procesin e nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi, në kundërshtim me pikën 5, pikën 96, të Udhëzimit-it të Ministrisë së Financave Nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet 46-54 të Raportit përfundimtarë të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Drejtuesi i Agjencisë Kombëtare të Pyjeve (me propozim të nëpunësit zbatues) të marrë masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për procesin e vlerësimit të aktiveve dhe procesin e nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi.

Menjëherë

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. Agjencia Kombëtare e Pyjeve me shkresën nr. 9 prot, datë 05.01.2023 drejtuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe me shkresën nr. 10 prot, datë 05.01.2023 drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, ka kërkuar dokumentacionin shoqërues të aktiveve të marra me transferim kapital pa pagesë nga ish- ISHMPUT dhe nga AKM, me historikun e tyre, me datën e daljes në përdorim, me datën e skadencës të aktiveve, etj, në mënyrë që Agjencia Kombëtare e Pyjeve të vazhdojë me procedurat e vlerësimit të aktiveve dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të tyre.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se blerjet e ndryshme janë dokumentuar me fletëdaljet dhe fletëhyrjet, por nuk janë reregjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin analitik të magazinës, -fletëhyrjen ku janë pasqyruar aktivet e transferuara nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, nuk përmban shënimin "vlera në ruajtje", në kundërshtim me pikën 49, të Udhëzimit-it Nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", si dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 3 dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022 NË AGJENCIA KOMBËTARE E PYJEVE TIRANË"

Udhëzimit Nr.8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore, në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", pika 28, -Gjithashtu lidhur me fletë –daljet e magazinës nuk janë prerë në bazë të urdhër-dorëzimeve të lëshuara nga urdhëruesi,UMF pika 38. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet 46-54 të Raportit përfundimtarë të Auditimit).

8.1.Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Pyjeve të marrë masa që të gjitha veprimet dhe faktet ekonomike të kryera nga njësia ti regjistrojë në mënyrë kronologjike në ditarin analitik të magazinës, si dhe daljet nga magazina, ti kryejë në bazë të urdhërdorëzimeve, fletë kërkesave të firmosur nga titullari i institucionit , planit të shpërndarjes të kartelës limit. Aktivitetet e marra në ruajtje të dokumentohen menjëherë me fletëhyrjen që përmban shënimin "vlera në ruajtje". Të bëhet korrigjimi i fletë hyrjeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. Agjencia Kombëtare e Pyjeve ka marrë masa që të gjitha veprimet ekonomike të kryera nga njësia të regjistrohen në mënyrë kronologjike në ditarin analitik. Të gjitha daljet nga magazina kryhen në bazë të fletë-kërkesave të miratuara e firmosur nga personi përgjegjës i caktuar nga titullari. Aktivitetet e marra në ruajtje/përdorim nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit në datën 29.12.2020 janë dokumentuar me fletë-hyrjen përkatëse dhe janë korrigjuar me shënimin "vlera në ruajtje".

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

9-Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Pyjeve nga auditimi rezultoi së është jashtë sistemit të inspektimit, kryesisht për shkak se nuk janë unifikuar me Inspektoratin Qendror praktikave të kontrollit dhe inspektimit në fondin pyjor kombëtar nga strukturat përgjegjëse në ushtrimin e kompetencave të tyre, sipas nenit 40 të ligjit nr.57/2020 për Pyjet. Për pasojë, kjo Agjenci për periudhën 2020-2022, ka qenë në pamundësi, si juridikisht ashtu edhe nga logjistike (mungojnë procesverbale të konstatimit të dëmeve etj.) për të ushtruar veprimtari të mirëfilltë inspektuese. Paqartësia vet brenda ligjit si dhe mungesa e harmonizimit me ligje të tjera, ka bërë që funksionin e inspektimit të pyjeve ta realizojë Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, institucion ky nuk njihet si institucion monitorues inspektues sipas ligjit nr.57/2020. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet 54-63 të Raportit përfundimtarë të Auditimit).

9.1.Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Pyjeve, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit si dhe me Inspektoratin Qendror, të marrë masa për unifikimin e praktikave të kontrollit dhe procesit të inspektimit në fondin pyjor.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. Agjencia Kombëtare e Pyjeve, ka dërguar për miratim në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit me shkresën nr. 28 prot., datë 16.01.2023.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar .

10.Gjetje nga auditimi: Aktet nënligjore plotësuese në zbatim të ligjit nr.57/2020 "Për Pyjet" ende nuk janë miratuar, konkretisht mungojnë rreth 18 VKM dhe udhëzime, ndër të tjera, si më poshtë: Në zbatim të nenit 4 pika 2 duhej të ishte miratuar udhëzimi për klasifikimin e pyjeve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022 NË AGJENCIA KOMBËTARE E PYJEVE TIRANË”

Në zbatim të nenit 5, pika 4, nuk është miratuar VKM për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre.

c. Në zbatim të nenit 38 pika 8, nuk është miratuar udhëzimi me procedura dhe vendimmarrja për dënimin dhe masat përkatëse, ankimi dhe ekzekutimi rregullohen nga legjislacioni në fuqi për kundërvajtjet administrative dhe inspektimin. Përmbajtja dhe modelet e akteve për kundërvajtjet në pyje miratohen me urdhër të ministrit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 54-63 të Raportit përfundimtarë të Auditimit).*

10.1.Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Pyjeve, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për identifikimin e të gjitha akteve nënligjore që nuk janë miratuar dhe miratimin e tyre.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin . Agjencia Kombëtare e Pyjeve, ka identifikuar të gjitha aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”. Për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore nuk është detyrë e AKP-së, gjithsesi Agjencia ka kontribuar në hartimin e tyre, ka dhënë mendim për të gjitha aktet, për të cilat ka qenë e detyrueshme për dhënien e mendimit.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

11.Gjetje nga auditimi: Në lidhje me procesin inventarizimit të fondit pyjor konstatohet se inventari i fundit i përket vitit 2018 e për rrjedhojë rezulton se nuk ka nisur cikli i radhës 8 vjeçar i riinventarizimit kombëtar të pyjeve, duke inventarizuar 25% çdo 2 vjet të fondit pyjor, në kundërshtim me nenin 6 të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet. Nga krahasimi i inventarëve 2003-2018, nga vëllimi total drunor, është hequr për 15 vjet një vëllim prej 32.9 mln m³ (përfshi materialin drusor të djegur nga zjarret në pyll), pra 2.2 mln/m³/vit, ose dyfishin e mundësisë vjetore të shfrytëzimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet 54-63, të Raportit përfundimtarë të Auditimit).*

11.1.Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Pyjeve të marrë masa që të nisë procesin e inventarizimit të fondit pyjor, duke parashikuar në buxhetin e vitit 2023 të gjitha kostot e mundshme, përfshirë ngritjen e agjencive rajonale të pyjeve, për përfundimin e procesit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. Agjencia Kombëtare e Pyjeve, ka bërë hartimin e programit për nisjen e procesit të Inventarit Kombëtar të Pyjeve dhe Kullotave për vitin 2023, ka parashikuar buxhetin që kërkohet realizmin e procesit për vitin 2023 dhe programin për fillimin e procesit, e ka dërguar për miratim në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit. Për kryerjen e punës në terren, duhet të krijohen grupet e punës që do të kryejnë matjet në terren dhe për këtë është kërkuar krijimi i Degëve Rajonale të AKP-së.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

12.Gjetje nga auditimi: Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor (RKFP) nuk është i plotë, pasi në këtë fond pyjor nuk janë të pasqyruara ato sipërfaqe pyjorë të cilat i kanë kaluar në pronësi Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet VKM-së Nr. 707, datë 21.11.2018 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin të disa pronave të paluajtshme shtetërore, në vijën bregdetare Shkodër-Fier”. Sipas nenit 2 të ligjit nr.57/2020 “Për pyjet”, ligji i shtrin efektet për çdo sipërfaqe pyjore pavarësisht pronësisë, për sa kohë plotësohet kushti i përkufizimit të



KONTROLLI I LARTË I SHITIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022 NË AGJENCIA KOMBËTARE E PYJEVE TIRANË”

“pyllit”, pavarësisht administrimit qoftë privat apo publik. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet 54-63 të Raportit përfundimtar të Auditimit).

12.1.Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Pyjeve të marrë masa për përditësimin e regjistrit kombëtar të fondit pyjor me sipërfaqet që i kanë kaluar në administrim Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar **por nuk është zbatuar.**

13.1.Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Pyjeve të marrë masa që procedurat për heqjen nga regjistri i fondi pyjor të sipërfaqeve që preken nga investimet strategjike, t'i nisë vetëm pas administrimit të projekteve për zëvendësimin e këtyre sipërfaqeve dhe marrjes së konfirmimit nga MTM për nxjerrjen e akteve(VKM apo Ligji) për heqjen nga fondi pyjor.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe **i pa zbatuar.**

13.Gjetje nga auditimi: Me vendimet e Komitetit të Investimeve Strategjike lihen detyra për heqjen nga fondi pyjor para marrjes në përdorim të sipërfaqes përkatëse apo ngarkimin e AKP-së me saktësimin e koordinatave apo verifikime të pronës. Po ashtu, kërkohet çregjistrimi nga kadastra dhe fondi pyjor, shoqëruar me detyrimin e subjektit përfitues që të paguajë vlerat përkatëse të pakësimit të volumit të lëndës drusore, të sipërfaqes që do të hiqet nga fondi pyjor si dhe pyllëzimin e një sipërfaqeje tjetër. Për këto detyra, rezulton se Agjencia Kombëtare e Pyjeve gjendet e përjashtuar nga këto procese, së pari ende nuk administron në mënyrë të plotë fondin pyjor, së dyti rezulton e përjashtuar nga proceset e kadastrës pyjore, sa i përket çregjistrimit, heqjes nga fondi pyjor dhe zëvendësimit, pasi kjo agjenci nuk harton/miraton asnjë akt administrativ mbi këto çështje dhe nuk informohet nga MTM mbi vendimet e Këshillit të Ministrave për heqjen nga fondi pyjor. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 54-63 të Raportit përfundimtar të Auditimit).

14.1.Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Pyjeve, në bashkëpunim me AKSHI-n, të marrë masa për ngritjen e një grupi ekspertësh të fushës së pyjeve, specialistë IT dhe programues për analizimin e popullimit të të dhënave të hasura me probleme dhe plotësimin e sistemit ALFIS me sipërfaqet që janë nën administrim të Agjencisë së Zonave të Mbrojtura dhe Ministrive.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. Në mënyrë të vazhdueshme nga ana e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve është kërkuar specialist IT dhe GIS.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar **por është zbatuar pjesërisht.**

14.Gjetje nga auditimi: Procesi i dixhitalizimi të fondit pyjor në sistemin ALFIS është i paplotë, pasi rezulton se është pasqyruar pjesërisht vetëm fondi pyjor nën administrimin e bashkive dhe jo sipërfaqet pyjore të ministrive dhe Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. Sipërfaqja totale kombëtare e dixhitalizuar është 1.213.427,83 ha, (për 61 bashkitë). Në veçanti, sipërfaqet pyjore që preken nga investimet strategjike nuk janë të pasqyruara në ALFIS. Nga kontrolli i VKM-ve të miratuara sipas “Listave të transferimit të ngastrave pyjore kullimore në pronësi të bashkisë” për periudhën 2020-2021, rezulton me mospërputhje të konsiderueshme në zërat kadastral si



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022 NË AGJENCIA KOMBËTARE E PYJEVE TIRANË”

“Kategoria e Përdorimit të Territorit”, “Pronësia”, “Sipërfaqja” etj. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 54-63 të Raportit përfundimtarë të Auditimit).

15.1.Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Pyjeve, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, të marrë masa që të krijojë një nën regjistër të veçantë për sipërfaqet e hequra ndër vite nga fondi pyjor si dhe të informojë bashkitë për përditësimin e të dhënave kadastrale sipas planeve të mbarështimit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

16.Gjetje: Nga auditimi rezultoi se në Agjencia Kombëtare të Pyjeve, nuk ka gjete zbatimi Vkm-ja nr.570 datë 17.7.2019 “Për Krijimin organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”, pika 5.4 “Në lidhje me menaxhimin e pyjeve pika ç) harton, zbaton dhe monitoron ndikimet dhe efektshme rinë e planeve të menaxhimit të pyjeve dhe të planeve të mbarështimit” nuk ka funksionuar në çdo raste pasi hartimin dhe miratimi e planeve të mbarështimit janë përgatitur dhe miratuar nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, si dhe nga Njësitet e Qeverisjes Vendore .

-Nga 385 ekonomi pyjore në gjithë vendin vetëm (20 %) prej tyre janë të pajisura me plane mbarështimi apo plane që janë në proces.

-Në 21 bashkitë që kanë mbuluar 4% - 100% të territorit me plane mbarështimi, pjesa tjetër prej 40 bashkish nuk kanë hartuar asnjë plan mbarështimi të paktën 10 vitet e fundit, veprime në kundërshtim të ligjit 57/2020, neni 11. Hartimi i planit të mbarështimit është një detyrim ligjor për pronarët e pyjeve(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 63-81 të Raportit përfundimtarë të Auditimit).

16.1.Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Pyjeve, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe drejtoritë përkatëse të marrin masa që në çdo rast planet e menaxhimit të përcillen para në Agjencisë Kombëtare të Pyjeve për dhënie mendimi, deri në finalizimet e procesit të hartimit dhe miratimit të planeve të mbarështimit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin.

Drejtori i Përgjithshëm i AKP ka përcaktuar personat përgjegjës për Shqyrtimin e Planeve të Menaxhimit, ku personat e caktuar janë z. B.H., Përgjegjës Sektori i Vlerësimit të Gjendjes së Pyjeve, dhe znj. B. H., Specialist, Sektori i Mbarështimit & Dokumenteve Planifikues.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

17-Gjetje: Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Menaxhimit në AKP, ka kryer kontrole sipas ligjit nr. 57 të Pyjeve, në katër Bashki nga të cilat në dy Bashkia ka dalë në vendim përfundimtarë ku ka përcjellë bashkive gjetje dhe rekomandime, këto veprime nuk janë në përputhjeje me ligjin e sipërcituar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 63-81 të Raportit përfundimtarë të Auditimit).

17.1.Rekomandim; Drejtoria e Menaxhimit pranë Agjencia Kombëtare e Pyjeve, të marrë masa për të hartuar metodologji, manual apo urdhër të Drejtorit, në përputhje me kontrollet e kryera për daljen në përfundim për gjetje dhe rekomandime.

Menjëherë

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. Drejtori i Përgjithshëm i AKP nxjerr



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022 NË AGJENCIA KOMBËTARE E PYJEVE TIRANË”

Urdhra për kryerjen e kontroleve (rutine ose/dhe rast pas rasti), në të cilët vendos dhe detyrat e anëtarëve të grupit të përkatës.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

18. Gjetje: Agjencia Kombëtare e Pyjeve, nga auditimet e ushtruara në Bashkitë përkatëse, për subjektet që ushtojnë aktivitet, për përdorimin e sipërfaqeve me lënde drusore, nuk ka dhënë rekomandime sipas përcaktimeve të nenit 38 “Procedimi në fondin pyjor” pika 6. Për subjektet e dënuara, struktura përgjegjëse për pyjet, sipas këtij ligji, paraqet kërkesën për heqjen e licencës përkatëse dhe autoritetet përgjegjëse janë të detyruara të marrin vendim për heqjen e licencës brenda pesë ditëve. Subjekti, të cilit i është hequr licenca, nuk mund të pajiset më me të njëjtën licencë për 5 vjetët në vijim. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 63-81 të Raportit përfundimtarë të Auditimit).*

18.1.Rekomandim; Agjencia Kombëtare e Pyjeve, strukturat e kontrollit /monitorimit, në çdo rast që konstatojnë shkelje të subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fondin pyje të marrin masa për heqjen e licencës përkatëse.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. Agjencia Kombëtare e Pyjeve ka rekomanduar rast pas rasti, ndjekjen e procedurave administrative ndaj subjekteve kontraktore përgjegjëse, si dhe marrja e masave disiplinore administrative ndaj punonjësve të strukturave pyjore të bashkive, për mospërbushjen e detyrimeve ligjore.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

19. Gjetje: Nga auditimi i kryer në Agjencia Kombëtare e Pyjeve rezulton se; Strukturat e pyjeve pranë bashkive në të shumtat e rasteve nuk kanë informacion dhe nuk japin asnjë sqarim se për çfarë është përdorur fondi i grumbulluar, për një periudhë gati 8 vjeçare, nga të ardhurat nga pyjet dhe kullotat që bashkitë administrojnë, në vlerën prej **96,031,896** lekë.

Në pjesën më të madhe të bashkive rezulton se nuk ka gjetur zbatim investimi i fondit të grumbulluar për hartimin e projekteve për rehabilitimin *(me pyllëzime)* të sipërfaqeve të djegura dhe të degraduara, veprim në kundërshtim me nenin 13, pika 3, të Ligjit nr. 57/2020 datë 30.04.2020 “Për pyjet”, të ardhurat nga të gjitha aktivitetet e mundshme në fondin pyjor përdoren 100%, për investime në fondin pyjor/kullosor *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet 63-81 të Raportit përfundimtarë të Auditimit).*

19.1.Rekomandim; Agjencia Kombëtare e Pyjeve, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe strukturat e Bashkive të marrin masa, që të ardhurat e krijuara nga fondi pyjor të përdoren për investime në vitin e ardhshëm.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. Agjencia Kombëtare e Pyjeve, ka dërguar shkresa drejtuar 61 Bashkive në Republikën e Shqipërisë, për mbledhjen e informacionin.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

20. Gjetje Për periudhën e audituar, ndonëse ka qenë i miratuar ligji nr. 5/2016 “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”, ky ligj dhe VKM nr.438 datë 08.06.2016 që pasoi e lejuan vazhdimësinë e kontratave të subjekteve private për shfrytëzimin e pyjeve me disa kushtëzime si shfrytëzimi i ngastrave të bëhet vetëm me qellim, shëndetësimin e pyjeve pastrimin e mbeturinave dhe enteve tjera për dru zjarri, kushte këto që nuk janë zbatuar sikurse është konstatuar nga vet kontrolltet e kryera nga AKP. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet 63-81 të Raportit përfundimtarë të Auditimit)*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022 NË AGJENCIA KOMBËTARE E PYJEVE TIRANË”

20.1.Rekomandim; Agjencia Kombëtare e Pyjeve të marrë masa për kryerjen e vlerësimit të moratoriumit në pyje, përfshirë dhe kontratat e subjekteve private me një afat 10–vjeçar.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. Agjencia Kombëtare e Pyjeve ka rekomanduar ndjekjen e procedurave administrative ndaj subjekteve kontraktore përgjegjëse, si dhe marrja e masave disiplinore administrative ndaj punonjësve të strukturave pyjore të bashkive, për mospërmbushjen e detyrimeve ligjore.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

21.Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit u konstatua se, për nëpunësit e Agjencia Kombëtare e Pyjeve, zbatohen procedurat e legjislacionit për nëpunësin civil parashikuar për institucionet e administratës shtetërore. Nga auditimi me përzgjedhje i dosjeve të personelit rezultoi se, ato administrohen të inventarizuara në zbatim VKM nr.117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet 23-27 të Raportit përfundimtarë të Auditimit).

21.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Sektori Personelit) të sistemojë dhe kompletojë dosjet e punonjësve me dokumentacionin përkatës si dhe të kryhet rekrutimi i punonjësve për plotësimin e vendeve të punës.

Në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin, ka plotësuar dosjet sipas cdo punonjësi.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Pyjeve (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), në 4 raste, për shumën 44,419 lekë, sipas urdhër shpenzimeve nr. 19, datë 04.03.2021, nr. 17, datë 25.02.2021, nr. 45, datë 15.04.2022, nr. 27, datë 02.03.2022, ka likuiduar DRSHTRR Tiranë për pagesa gjobash për vonesa, brenda vlerës së përgjithshme, sipas dokumenteve për taksa makine, *gjoba për te cilat duhej të nxirrej përgjegjësia dhe të paguheshin prej personave përgjegjës, për rrjedhojë nuk duhej të paguhej shuma prej 44,419 lekë* nga AKP. -Sa sipër bie në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet 46-54 të Raportit përfundimtarë të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Pyjeve (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të përcaktojë përgjegjësitë lidhur me gjobat e paguara sipas urdhër shpenzimeve nr. 19, datë 04.03.2021, nr. 17, datë 25.02.2021, nr. 45, datë 15.04.2022, nr. 27, datë 02.03.2022 dhe më pas të ndjekë gjithë rrugët ligjore për arkëtimin e shumës 44,419 lekë sipas dokumenteve për taksa makine, prej përfituesit në të kundërt shuma të zhdëmtohet nga personat përgjegjës.

Brenda muajit Mars 2023

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin . Agjencia Kombëtare e Pyjeve është ende në proces për përcaktimin e përgjegjësive lidhur me gjobat e paguara sipas urdhër shpenzimeve të mëposhtme:

- Urdhër shpenzim nr. 17, datë 25.02.2021 – Gjoba KTV për automjetet me targa AA 190 JM, AA 542 PK, TR 8733 L, në vlerën prej 3,000 lekë;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022 NË AGJENCIA KOMBËTARE E PYJEVE TIRANË”

- Urdhër shpenzim nr. 19, datë 04.03.2021 – Gjoha TVMP për automjetet me targa AA 190 JM, TR 8733 L, TR 8785 L, në vlerën prej 1,090 lekë;
- Urdhër shpenzim nr. 27, datë 02.03.2022 – Gjoha TVMP për automjetin me targë SH 5675 E, në vlerën prej 329 lekë;
- Urdhër shpenzim nr. 45, datë 15.04.2022 – Gjobë për ndryshim pronësie jashtë afatit për automjetin me targë AB 978 GB (targa e vjetër SH 5675 E), në vlerën prej 40,000 lekë.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

B.1. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1.Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Pyjeve, në 22 raste për shumën e përgjithshme 13,625,229 lekë, si rezultat i dhënies së masave ekstreme disiplinore “Largim nga Shërbimi Civil” si dhe zgjidhjes së kundërligjshme të kontratave të punonjësve të pabazuara në ligj dhe në Kodin e Punës, kanë sjellë kundërpërgjigje nga punonjësit e institucionit të cilët kanë bërë padi në gjykatë ku kanë fituar të drejtën e tyre në shkallën e parë ose edhe në shkallën e dytë të gjyqimit dhe për pasojë nga shteti janë shpenzuar 13,625,229 lekë, ku përfshihet edhe pagesa e përmbauesve gjyqësorë për kompensimin e punonjësve të larguar padrejtësisht, duke shkaktuar efekte ekonomike negative në administrimin e fondeve publike, me pagesën e 2 personave për të njëjtin vend pune. Sa sipër është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës I Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjin për Shërbimin Civil në RSH. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet 54-63 të Raportit përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandim: Drejtori i Agjencisë Kombëtare e Pyjeve, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa në të ardhmen për eliminimin e rasteve, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me efekt negativ për likuidimin e vendimeve gjyqësore, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për shërbimin civil “krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike” si dhe Kodit të Punës.

Në vijimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. **Statusi i rekomandimit:** Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

Për përmirësimin e punës në të ardhmen, rekomandojmë:

A. MASA ORGANIZATIVE

Nga auditimi i mëparshëm Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 891/6 prot, datë 18.01.2023 ka dërguar në Agjencisë Kombëtare të Pyjeve Tiranë Raportin Përfundimtar të Auditimit së bashku me rekomandimet përkatëse si vijon:

1. Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), për të 3 vitet 2020, 2021, 2022, referuar ligjeve “Për buxhetin e vitit 2020, 2021, 2022”, të ndryshuar, nga ana e këtij institucioni është dërguar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, kërkesa nr. 49, datë 21.09.2020, ku paraqitet gjendja financiare dhe fakti i mungesës së buxhetit, si rrjedhojë pamundësia e përmbushjes së detyrave të caktuara më aktet ligjore e nënligjore në fuqi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022 NË AGJENCIA KOMBËTARE E PYJEVE TIRANË”

Për vitin 2021, sipas tabelës së paraqitur rezulton se buxheti i vitit 2021 është realizuar në masën 94 %, pra me mosrealizim, dhe në vlerë absolute me një vlerë prej 3,080,225 lekë diferencë e porealizuar.

Mosrealizimet e rezultuara, tregojnë në mënyrë eksplicite faktin se sa i shkëputur ka qenë procesi i hartimit të planit nga situata dhe nevojat faktike, sidomos për mirëmbajtjen a automjeteve, të pajisjeve të zyrave, deri tek zëri “Shpenzime për të tjera materiale dhe shërbime”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 8-8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për të ardhmen, të argumentojë kërkesat për fonde me vërtetësi dhe realizëm, duke shmangur si keqpërdorimin e fondeve në rastin e planifikimit të fryrë, ashtu edhe mosrealizimin e detyrave ligjore operative të institucionit në funksion të ligjit, me qëllim rritjen e performancës në aktivitetin e tij.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

6. Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), lidhur me veprimet e kryera nëpërmjet bankës, në 4 raste të shërbimeve të kryera automjeteve, nga ana e Sektorit të Financës nuk është aplikuar administrimi i pjesëve të vjetra, në 1 rast, Shërbim riparim automjeti, 36,000 lekë pjesëve të këmbimit, të cilat duheshin bërë hyrje në magazinë të veçantë (rikupero). (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet 8-8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Pyjeve, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa dhe të krijojë magazinë rikupero lidhur me administrimin e pjesëve të vjetra të automjeteve në rastet e shërbimeve të kryera dhe trajtimin e mëtejshëm të tyre.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

11.Gjetje nga auditimi: Në lidhje me procesin inventarizimit të fondit pyjor konstatohet se inventari i fundit i përket vitit 2018 e për rrjedhojë rezulton se nuk ka nisur ciklin e radhës 8 vjeçar i riinventarizimit kombëtar të pyjeve, duke inventarizuar 25% çdo 2 vjet të fondit pyjor, në kundërshtim me nenin 6 të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet. Nga krahasimi i inventarëve 2003-2018, nga vëllimi total drunor, është hequr për 15 vjet një vëllim prej 32.9 mln m³ (përfshi materialin drusor të djegur nga zjarret në pyll), pra 2.2 mln/m³/vit, ose dyfishin e mundësisë vjetore të shfrytëzimit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 8-8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1.Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Pyjeve të marrë masa që të nisë procesin e inventarizimit të fondit pyjor, duke parashikuar në buxhetin e vitit 2023 të gjitha kostot e mundshme, përfshirë ngritjen e agjencive rajonale të pyjeve, për përfundimin e procesit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

12.Gjetje nga auditimi: Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor (RKFP) nuk është i plotë, pasi në këtë fond pyjor nuk janë të pasqyruara ato sipërfaqe pyjorë të cilat i kanë kaluar në pronësi Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet VKM-së Nr. 707, datë 21.11.2018 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin të disa pronave të paluajtshme shtetërore, në vijën bregdetare Shkodër-Fier”. Sipas nenit 2 të ligjit nr.57/2020 “Për pyjet”, ligji i shtrin efektet për çdo sipërfaqe pyjore pavarësisht pronësisë, për sa kohë plotësohet kushti i përkufizimit të “pyllit”, pavarësisht administrimit qoftë privat apo publik. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet 8-9 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022 NË AGJENCIA KOMBËTARE E PYJEVE TIRANË”

12.1.Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Pyjeve të marrë masa për përditësimin e regjistrit kombëtar të fondit pyjor me sipërfaqet që i kanë kaluar në administrim Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

13.Gjetje nga auditimi: Me vendimet e Komitetit të Investimeve Strategjike lihen detyra për heqjen nga fondi pyjor para marrjes në përdorim të sipërfaqes përkatëse apo ngarkimin e AKP-së me saktësimin e koordinatave apo verifikime të pronës. Po ashtu, kërkohet çregjistrimi nga kadastra dhe fondi pyjor, shoqëruar me detyrimin e subjektit përfitues që të paguajë vlerat përkatëse të pakësimit të volumit të lëndës drusore, të sipërfaqes që do të hiqet nga fondi pyjor si dhe pyllëzimin e një sipërfaqeje tjetër. Për këto detyra, rezulton se Agjencia Kombëtare e Pyjeve gjendet e përjashtuar nga këto procese, së pari ende nuk administron në mënyrë të plotë fondin pyjor, së dyti rezulton e përjashtuar nga proceset e kadastrës pyjore, sa i përket çregjistrimit, heqjes nga fondi pyjor dhe zëvendësimit, pasi kjo agjenci nuk harton/miraton asnjë akt administrativ mbi këto çështje dhe nuk informohet nga MTM mbi vendimet e Këshillit të Ministrave për heqjen nga fondi pyjor. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 9-9 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1.Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Pyjeve të marrë masa që procedurat për heqjen nga regjistri i fondi pyjor të sipërfaqeve që preken nga investimet strategjike, t'i nisë vetëm pas administrimit të projekteve për zëvendësimit e këtyre sipërfaqeve dhe marrjes së konfirmimit nga MTM për nxjerrjen e akteve (VKM apo Ligji) për heqjen nga fondi pyjor.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

14. Gjetje nga auditimi: Procesi i dixhitalizimi të fondit pyjor në sistemin ALFIS është i paplotë, pasi rezulton se është pasqyruar pjesërisht vetëm fondi pyjor nën administrimin e bashkive dhe jo sipërfaqet pyjore të ministrive dhe Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. Sipërfaqja totale kombëtare e dixhitalizuar është 1.213.427,83 ha, (për 61 bashkitë). Në veçanti, sipërfaqet pyjore që preken nga investimet strategjike nuk janë të pasqyruara në ALFIS. Nga kontrolli i VKM-ve të miratuara sipas “Listave të transferimit të ngastrave pyjore kullosore në pronësi të bashkisë” për periudhën 2020-2021, rezulton me mospërputhje të konsiderueshme në zërat kadastral si “Kategoria e Përdorimit të Territorit”, “Pronësia”, “Sipërfaqja” etj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet, 9-9 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1.Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Pyjeve, në bashkëpunim me AKSHI-n, të marrë masa për ngritjen e një grupi ekspertësh të fushës së pyjeve, specialistë IT dhe programues për analizimin e popullimit të të dhënave të hasura me probleme dhe plotësimin e sistemit ALFIS me sipërfaqet që janë nën administrim të Agjencisë së Zonave të Mbrojtura dhe Ministrive.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

15.Gjetje nga auditimi: Problematikë kryesore në sektorin e inventarizimit vitin 2021 ka qenë mungesa e të dhënave mbi VKM-të e hartuara ndër vite për sipërfaqet e hequra nga fondi pyjor/kullosor si dhe sipërfaqet pyjore kullosore pronë private. Në evidencat e tregueseve kadastral që përcaktojnë fondin pyjor/kullosor të bashkive, nuk janë hedhur të dhënat kadastrale të konfirmuara nga planet e reja të mbarështimi të 3-4 viteve të fundit. Konkretisht problematike janë bashkitë, Berat, Maliq, Malësi e Madhe, Has, të cilat janë realizuar me program pilot. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 9-10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1.Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Pyjeve, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, të marrë masa që të krijojë një nën regjistër të veçantë për sipërfaqet e hequra ndër vite



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022 NË AGJENCIA KOMBËTARE E PYJEVE TIRANË”

nga fondi pyjor si dhe të informojë bashkitë për përditësimin e të dhënave kadastrale sipas planeve të mbarështimit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Pyjeve (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme) në 4 raste, për shumën **44,419 lekë**, sipas urdhër shpenzimeve nr.19 datë 04.03.2021, nr. 17, datë 25.02.2021, nr. 45, datë 15.04.2022, nr. 27, datë 02.03.2022, ka likuiduar DRSHTRR Tiranë për pagesa gjobash për vonesa, brenda vlerës së përgjithshme, sipas dokumenteve për taksa makine, *gjoba për te cilat duhej të nxirrej përgjegjësia dhe të paguheshin prej personave përgjegjës, për rrjedhojë nuk duhej të paguhej shuma prej 44,419 lekë nga AKP.*

-Sa sipër bie në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet 10-10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Pyjeve (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të përcaktojë përgjegjësitë lidhur me gjobat e paguara sipas urdhër shpenzimeve nr. 19, datë 04.03.2021, nr. 17, datë 25.02.2021, nr. 45, datë 15.04.2022, nr. 27, datë 02.03.2022 dhe më pas të ndjekë gjithë rrugët ligjore për arkëtimin e shumës **44,419 lekë** sipas dokumenteve për taksa makine, prej përfituesit në të kundërt shuma të zhdëmtohet nga personat përgjegjës.

Brenda muajit Dhjetor 2023

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT

1. V. B., Përgjegjës Grupi
2. Sh. H.j , auditues

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

A.Z.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT TIRANË , DURRËS, DIBËR

PROJEKT RAPORT I AUDITIMIT TEMATIK

“PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA”

AGJENCIA RAJONALE E MJEDISIT TIRANË DURRËS DIBËR

	Përmbajtja	1-1
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	2-2
	1.Përshkrim i shkurtër Projektit të Auditimit	2-2
	2.Përshkrim i gjetjeve kryesore	3-4
	3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	4-4
II	HYRJE	4-5
	2. Qëllimi	5-5
	3. Identifikimi i çështjes	5-5
	4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	5-5
	5. Përgjegjësitë e audituesve	5-5
	6. Kriteret e vlerësimit	5-5
	7. Standardet e Auditimit	6-6
	8. Metodatat e auditimit	6-6
	9. Dokumentimi i auditimit	6-6
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	6-6
1	Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	6-6
2	Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit	6-6
2.1	Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".	6-6
2.2	Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	7-7
2.3	Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht,sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	7-7
2.4	Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	7-7
IV.	Gjetje dhe Rekomandime	8-10



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT TIRANË , DURRËS, DIBËR

I. Përmbledhje Ekzekutive

1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (në vijim KLSH) ushtroi auditimin tematik me objekt “Mbi nivelin e zbatimit të të rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022” Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me verifikimin dhe vlerësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Gjatë auditimit në terren nga grupi i auditimit është mbajtur 1 akt-verifikim, sipas çështjeve respektive, i cili është dorëzuar në protokollin e subjektit. Në përfundim të punës në terren është kryer takimi përmblyës me përfaqësuesit e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër.

I.2. Në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet më të rëndësishme të auditimit, paraqiten si më poshtë vijon:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT TIRANË , DURRËS, DIBËR

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër në bashkëpunim me Sektorin e Financës, Sektorin e Mjedisit dhe Sektorin Juridik të marrë masa për aplikimin dhe kontabilizimin e gjobës në masën 300 mijë lekë për çdo subjekt i cili nuk ka depozituar raportet e monitorimit mjedisorë dhe të kriterëve të tjera, si dhe të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e tyre.			Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës dhe Dibër të marrë masa që sektori i Mjedisit dhe Ujërave të hartojë raporte javore dhe mujore për njohjen e problematikave të subjekteve të inspektimit.
2	Në 12 raste në inspektimet e kryera nga inspektorët në procesverbal thuhet se:“subjekti u gjend i mbyllur”,ose nuk gjendet në adresën e dhënë. Inspektimet janë kryer në mungesë të përfaqësuesit të subjektit dhe nuk është lënë detyrë për paraqitje në ARM për marrje dijoni të problemeve të trajtuara, Nuk ka verifikime të dokumentuara në sistemin e QKL-së,-Nuk ka dokumente për bashkëpunimin dhe rezultatet e tij me institucione të tjera. Veprime në kundërshtim me nenin Neni 36- <i>Detyrimet e subjektit të inspektimit pika “d”</i> ; me ligjin nr. 10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” seksioni 2 neni 62-66 “Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit” si dhe me ligjin nr.10433 datë 16.06.2011“Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” nenin 45-48,ku neni 45; nenin 11“Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimi” të ligjit nr. 10431, datë 9.06.2011“Për Mbrojtjen e Mjedisit”.			Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës dhe Dibër në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të marrë masa për hartimin e një regjistri me subjektet e konstatuara të mbyllura nga inspektimet dhe të konfirmojë statusin e gjendjes së regjistrimit, aktiv apo pasiv si biznes në QKB.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT TIRANË , DURRËS, DIBËR

3	<p>Nga auditimi u konstatua se formulari i Inspektimit, për paragrafin “I”, pika 3 “Të dhënat të përgjithshme të subjektit”, “Lloji i aktivitetit ekonomik” gjenerohet nga sistemi dhe plotësohet me numër dhe jo me përshkrimin e aktivitetit në fjalë, gjë që e bën të pamundur të kuptohet lloji i aktivitetit që do të inspektohet kjo nga numri i lartë i aktiviteteve që operojnë në Qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Dibrës.</p>			<p>Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës dhe Dibër të marrë masa, që në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror, të përmirësojnë formatin elektronik, “pikën 3 Lloji i aktivitetit”, me qëllim që të identifikohet saktë veprimtaria dhe aktiviteti i subjektit në rubrikën përkatëse.</p>
4	<p>Nga auditimi u konstatua se: për periudhën objekt auditimi korrik 2020- dhjetor 2021 në praktikën e dhënies së mendimit për VNM dhe mendim për Leje të Tipit A e B në dosjet përkatëse mungojnë dokumente mbështetëse, dokumente këto paraprake, mbi të cilat përgatitet shkresa për dhënie mendimi. Nuk ka informacione nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për ecurinë e procedurës për praktika të dhënies të mendimit. Veprime në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe me Ligjin Nr.10440 datë .07.07.2011 “ Për vlerësimin e ndikimit në mjedis.</p>			<p>Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës dhe Dibër të marrë masa që:</p> <ul style="list-style-type: none">- Në praktikën e dhënies së mendimit për VNM apo mendime për Leje mjedisore Tipi A/B, të bashkëlidhin dhe përfshijnë në dosje dokumente plotësuese dhe mbështetëse, pasi të jenë miratuar me udhëzim formatet përkatëse, me synim që të vërtetojnë realizimin e procedurave dhe justifikojnë dhënien e mendimit.- Të kryejë korrespondencë zyrtare me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për marrjen e të dhënave që lidhen me ecurinë e praktikave të dhënies së mendimeve për VNM e leje mjedisore A/B me synim përditësimin në formë elektronike të regjistrit të lejeve të tipit A/ B dhe VNM-ve.

I.3. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Mbështetur në standardet e INTOSAI-t, Manualit të Përputhshmërisë, Manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, nga auditimi tematik i kryer në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër, rezultoi se niveli i zbatimit të rekomandimeve plotësisht , është në nivelin 76 %.Rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm janë pranuar plotësisht, ku për përmirësimin e gjendjes janë lënë 16 masa organizative, 1 masa me 3E, nga të cilat 12 janë zbatuar, ndërsa 2 janë zbatuar pjesërisht pa zbatuar 2 masë .
2 masa me efekt financiar nga të cilat 1 zbatuar pjesërisht, ndërsa 1 pa zbatuar.

I. HYRJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër, “Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar për periudhën 2022-2023”, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me: verifikimin



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT TIRANË , DURRËS, DIBËR

e respektimit të afatit 20-ditor dhe 6-mujor për kthim përgjigje mbi përgatitjen e plan-veprimit dhe informacionin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve; verifikimin e nivelit të zbatimit të masave për përmirësim ligjor, organizative dhe të ardhura të munguara.

Sipas Programit të Auditimit, nr. 656 datë 17.07.2023, auditimi u krye nga grupi auditues, si vijon:

1. V. B., Përgjegjës Grupi
2. Sh. H. , auditues

1. Objektivat e auditimit

Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme, procedurave për ndjekjen dhe dokumentimin e zbatimit të tyre, mbi zbatimin e afatit 20 ditore dhe 6 mujor të kthimit të përgjigjes, si dhe mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e zbatimit të rekomandimeve.

2. Qëllimi i auditimit

Të vlerësojë dhe evidentojë masat e marra nga subjektet përkatëse për zbatimin e rekomandimeve, hartimin e matricave (plan veprimi ose masash) për zbatimin e rekomandimeve. Të vlerësojë aktet administrative përkatëse (urdhurat) të nxjerra për zbatimin e rekomandimeve. Të vlerësojë dokumentacionin që shoqëron dhe vërteton zbatimin e rekomandimeve, si dhe të verifikojë nxjerrjen e vendimeve për fillimin e procedurave administrative për dhënien e masave disiplinore dhe pasqyrimin në dosjen personale të punonjësve. Të verifikojë dhe dokumentojë me kujdes nëse janë ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ato ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin e shpërblimit të dëmit ekonomik ose gjobave të vendosura.

3. Identifikimi i çështjes

Projekt Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë Durrës Dibër dhe përgjegjësive, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë Durrës Dibër, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e objektiv e profesional mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI.

6. Kriteret e vlerësimit

Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikën, është pasur si kriter vlerësues në radhë të parë:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Rregullorja e Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, e ndryshuar me Vendimin nr.107, datë 08.09.2017 të Kryetarit Të KLSH-së.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT TIRANË, DURRËS, DIBËR

- Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe regjistri elektronik institucional, miratuar me Vendimin nr.67, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së.

7. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar, si rrjedhojë edhe Projekt Raporti i Auditimit është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, Rregullores së Procedurave të Auditimit, Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

8. Metodologjia e auditimit

1. Auditim i plotë sipas cilësimeve të bëra në drejtimet e auditimit.
2. Verifikimi i Urdhërave, Udhëzimeve dhe çdo dokumenti ligjor të nevojshëm për zbatimin e rekomandimeve.

9. Dokumentimi i auditimit

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar është përgatitur Projektraporti i Auditimit, i cili do të jetë materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit për ridërgimin e rekomandimeve.

III. PËRSHKRIMI I I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër është e organizuar dhe funksionon në bazë të VKM-së, nr.568, datë 17.07.2019, "Për Krijimin dhe mënyrën e Organizimit të Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", dhe Urdhrit nr.23, të Kryeministrit, datë 03.02.2020 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së AKM-së. Ligjin Nr. 53/2020 "Rregulloren e funksionimit të Agjencisë" dhe akteve të nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm .

2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

1. Hartimi i plan-veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 gërma (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Nga auditimi u konstatua se:

- Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 115/9 prot, datë 20.06.2022, ka dërguar në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë Durrës Dibër Raportin Përfundimtar të Auditimit së bashku me rekomandimet përkatëse.

- Nga Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër janë marrë masa për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH duke hartuar plan veprimin mbi zbatimin e rekomandimeve (njoftuar KLSH me shkresë nr.prot.20, datë 20.07.2022) të lëna nga KLSH. Sipas plan veprimit dhe urdhërave përkatës janë caktuar strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve, afatet për zbatimin e tyre, si dhe treguesi i rezultateve të arritura, në përputhje me Ligjin nr.154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 15, gërma j. Me shkresë nr.941 prot., datë 15.07.2022 nga ana e Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë Durrës Dibër është kthyer përgjigje brenda 20 ditëve për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 gërma (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT TIRANË , DURRËS, DIBËR

- Nga ana e Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë Durrës Dibër nuk janë marrë masa për respektimin e afatit prej 6 (gjashtë) muajsh për raportimin në KLSH me anë të një informacioni të hollësishëm për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim me Ligjin nr.154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 30, pika 2. Me shkresë nr.986prot., datë 15.09.2023 është përcjellë relacioni për zbatueshmërinë e rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Niveli i pranimit dhe statusi sipas llojit të rekomandimit në numër dhe në vlerë

Nga ana e KLSH janë lënë **18 rekomandime** gjithsej, nga këto:

- **16 masa organizative**, nga të cilat 12 janë zbatuar, ndërsa 2 janë zbatuar pjesërisht pa zbatuar 2 masë .
- **2 masa me efekt financiare** nga të cilat 1 zbatuar pjesërisht, ndërsa 1 pa zbatuar.

Pasqyra e realizimit të detyrave të rekomanduara paraqitet si me poshtë:

Nr	Emërtimi	Rekomandimet ne numër :				Nga rekomandimet gjithsej: Sa me dëme ekonomike							
		Rekomandim gjithsej	Nga rekomandimet janë:			Rekomanduar Gjithsej		Nga rekomandimet janë:					
			Zbatuar	pjeserisht	Pa zbatuar	Nr. per	Në mijë/lek	Zbatuar arkëtuar		Zbatuar pjesërisht (në proces)		Pa zbatuar	
								Nr.	Në mijë/lek	Nr.	Në mijë/lek	Nr.	Në mijë/lek
1.	Masa organizative	16	12	2	2	0	0	0	0	0	0	0	0
2.	Masa për përmirësim ligjor	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3.	Shpërblim demi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
4.	Masa efekt financiar	2	0	1	1	2	42,000	0	0	0	0	1	42,000
	Totali	18	12	3	3	2	42,000	0	0	0	0	0	42,000

2.2. Zbatimi i rekomandimeve për përmirësim në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar. Subjekti nuk ka rekomandim për përmirësimi në legjislacionin.

Duke qenë se nuk nga auditimi i mëparshëm i KLSH nuk janë lënë rekomandime për përmirësim ligjorë atëherë kjo pikë e programit ezaurohet me këtë shënim.

2.3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht,sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve me karakter organizativ të lëna nga KLSH, u konstatua si vijon:

Agjencia Kombëtare e Pyjeve

Për sa është trajtuar në këtë Projekt Raport të Auditimit, nga subjekti i audituar, përkatësisht bashkia adym Tiranw me Drejtor Albion Kadriu, me shkresën e administruar në KLSH me nr.244/3datw 1010,2023, prot.656/7datë 10,11.2023,.

Pretendimi i subjektit:

-Lidhur me Akt verifikimin nr.3 të mbajtur nga KLSH, Departamenti i Auditimit të Performancës nga ana e subjektit ADZM Tiranw është dërguar observacion ku është bashkëlidhur shkresa përcjellëse dhe disa dokumenta fotokopje.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT TIRANË , DURRËS, DIBËR

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me sa më sipër observacioni i paraqitur merret në konsideratë pjesërisht dhe është reflektuar në raport përfundimtar.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

Për përmirësimin e punës në të ardhmen, rekomandojmë:

A. MASA ORGANIZATIVE

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 155/9 prot, datë 20.06.2022, nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet si vijon:

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në momentin e fillimit të inventarizimit në objekt, anëtarët e komisionit të inventarizimit nuk kanë përpiluar deklarata për konflikt të interesit me punonjësit me përgjegjësi materiale, ose që kanë në përdorim aktive, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 82.

Nga komisioni i inventarizimit nuk është kryer inventarizimin e llogarisë 215 “Mjete transport”, por janë mbajtur vetëm procesverbale marrje dorëzimi mbi gjendjen fizike, nuk janë hapur kartela përkatëse për çdo mjet ku të jenë firmosur nga personat që i kanë në përdorim.

Komisioni i inventarizimit fizik në përfundim të procesit nuk ka përgatitur raportin informues për të paraqitur te Titullari i njësisë shpenzuese, informacionin mbi gjendjen fizike të vlerave të aktiveve, veprim në mospërputhje me pika 85, germa (c) dhe 86 e UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2,2 faqet 6-7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.2. Rekomandimi: Sektori i Financës të krijojë regjistrin e aktiveve si dhe të hapë kartelat individuale për çdo punonjës, për aktivet që kanë në ngarkim.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se mungonin relacionet dhe raportet e inspektimeve të kryera nga Sektorët e Mjedisit dhe Ujërave, pasi ato realizoheshin vetëm për nivelin faktik dhe jo të tabeluar dhe krahasuar me treguesit e parashikuar në planet vjetore, megjithëse planet vjetore mungonin. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet 8-8të Projekt -Raportit të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës dhe Dibër të marrë masa që sektori i Mjedisit dhe Ujërave të hartojë raporte javore dhe mujore për njohjen e problematikave të subjekteve të inspektimit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

-Në 12 raste në inspektimet e kryera nga inspektorët në procesverbal thuhet se: “subjekti u gjend i mbyllur”, ose nuk gjendet në adresën e dhënë. Inspektimet janë kryer në mungesë të përfaqësuesit të subjektit dhe nuk është lënë detyrë për paraqitje në ARM për marrje dijeni të problemeve të trajtuara,

- Nuk ka verifikime të dokumentuara në sistemin e QKL-së,

- Nuk ka dokumente për bashkëpunimin dhe rezultatet e tij me institucione të tjera. Veprime në kundërshtim me nenin Neni 36- Detyrimet e subjektit të inspektimit pika “d”; me ligjin nr. 10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” seksioni 2 neni 62-66 “Inspektimi për mbrojtjen e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT TIRANË , DURRËS, DIBËR

Mjedisit” si dhe me ligjin nr.10433 datë 16.06.2011“Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” nenin 45-48,ku neni 45; nenin 11“Parimi i përgjegjësive së ndërsjellë dhe bashkëpunimi” të ligjit nr. 10431, datë 9.06.2011“Për Mbrojtjen e Mjedisit” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet 9-9 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1.Rekomandimi:Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës dhe Dibër në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të marrë masa për hartimin e një regjistri me subjektet e konstatuara të mbyllura nga inspektimet dhe të konfirmojë statusin e gjendjes së regjistrimit, aktiv apo pasiv si biznes në QKB.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se formulari i Inspektimit, për paragrafin “I”, pika 3 “Të dhënat të përgjithshme të subjektit”, “Lloji i aktivitetit ekonomik” gjenerohet nga sistemi dhe plotësohet me numër dhe jo me përshkrimin e aktivitetit në fjalë, gjë që e bën të pamundur të kuptohet lloji i aktivitetit që do të inspektohet kjo nga numri i lartë i aktiviteteve që operojnë në Qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Dibrës. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet 7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1. Rekomandimi: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës dhe Dibër të marrë masa, që në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror, të përmirësojnë formatin elektronik, “pikën 3 Lloji i aktivitetit”, me qëllim që të identifikohet saktë veprimtaria dhe aktiviteti i subjektit në rubrikën përkatëse.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

13.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se: për periudhën objekt auditimi korrik 2020-dhjetor 2021 në praktikat e dhënies së mendimit për VNM dhe mendim për Leje të Tipit A e B në dosjet përkatëse mungojnë dokumente mbështetëse, dokumente këto paraprake, mbi të cilat përgatitet shkresa për dhënie mendimi. Nuk ka informacione nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për ecurinë e procedurës për praktika të dhënieve të mendimit. Veprime në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe me Ligjin Nr.10440 datë .07.07.2011 “ Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet 10-10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1.Rekomandimi: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës dhe Dibër të marrë masa që:

- Në praktikat e dhënies së mendimit për VNM apo mendime për Leje mjedisore Tipi A/B, të bashkëlidhin dhe përfshijnë në dosje dokumente plotësuese dhe mbështetëse, pasi të jenë miratuar me udhëzim formatet përkatëse, me synim që të vërtetojnë realizimin e procedurave dhe justifikojnë dhënien e mendimit.

- Të kryejë korrespondencë zyrtare me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për marrjen e të dhënave që lidhen me ecurinë e praktikave të dhënies së mendimeve për VNM e leje mjedisore A/B me synim përditësimin në formë elektronike të regjistrit të lejeve të tipit A/ B dhe VNM-ve.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

B. TË ARDHURA TË MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër për 14 subjekte të cilat nuk kanë dorëzuar raportet e monitorimit mjedisor dhe kriteret e tjera ligjore, nuk ka marrë masa administrative me gjobë ndaj subjekteve përkatëse (nga 300 mijë lekë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT TIRANË , DURRËS, DIBËR

deri 500 mijë lekë), duke shkaktuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën **4,200 mijë lekë** ($300 \text{ mijë lekë gjoba minimale} \times 14 \text{ subjekte} = 4,200 \text{ mijë lekë}$) në kundërshtim me nenin 29 pika b (ii) të ligjit nr. 10488/2014 “Për lejet e mjedisit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet 10-10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandim: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër në bashkëpunim me Sektorin e Financës, Sektorin e Mjedisit dhe Sektorin Juridik të marrë masa për aplikimin dhe kontabilizimin e gjobës në masën 300 mijë lekë për çdo subjekt i cili nuk ka depozituar raportet e monitorimit mjedisorë dhe të kriterëve të tjera, si dhe të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e tyre.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi

GRUPI I AUDITIMIT

1. V. B., Përgjegjës Grupi
2. Sh. H. , auditues

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

A.Z.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË ADMINISTRATEN E ZONAVE TË MBROJTURA LEZHË

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK

“PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA

ADMINISTRATËN E ZONAVE TË MBROJTURA LEZHË

	Përmbajtja	1-1
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	2-2
	1.Përshkrim i shkurtër Projektit të Auditimit	2-2
	2.Përshkrim i gjetjeve kryesore	2-4
	3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	4-4
II	HYRJE	4-4
	2. Qëllimi	4-4
	3. Identifikimi i çështjes	4-4
	4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	5-5
	5. Përgjegjësitë e audituesve	5-5
	6. Kriteret e vlerësimit	5-5
	7. Standardet e Auditimit	5-5
	8. Metodatat e auditimit	5-5
	9. Dokumentimi i auditimit	5-5
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	5-6
1	Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	5-5
2	Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit	5-6
2.1	Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".	6-6
2.2	Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.	6-6
2.3	Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht,sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	6-9
2.4	Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomicitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.	6-6
IV.	Gjetje dhe Rekomandime	7-9



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË ADMINISTRATEN E ZONAVE TË MBROJTURA LEZHË

I.Përmbledhje Ekzekutive

1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (në vijim KLSH) ushtroi auditimin tematik me objekt “Mbi nivelin e zbatimit të të rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022” në Administratën e Zonave të Mbrojtura Lezhë duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me verifikimin dhe vlerësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Gjatë auditimit në terren nga grupi i auditimit është mbajtur 1 akt-verifikim, sipas çështjeve respektive, i cili është dorëzuar në protokollin e subjektit. Në përfundim të punës në terren është kryer takimi përmbyllës me përfaqësuesit e Administratën e Zonave të Mbrojtura Lezhë.

I.2. Në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet më të rëndësishme të auditimit, paraqiten si më poshtë vijon:

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	<p>Nga auditimi i kryer konstatohet se në tre raste ishin miratuar kontrata në kundërshtim me memon e hartuar nga drejtoria e projektit AKZM, ku theksohet se vend grumbullimi i mbetjeve urbane që mundë të gjenerohen gjatë zhvillimit të veprimtarisë dhe mënyrën e largimit tyre nga zona e mbrojtur të bëhet sipas një grafiku të miratuar respektivisht nga AdZM Lezhë dhe Bashkia përkatëse.</p> <p>-Në vitin 2021 janë lidhur 4 kontrata të cilat janë në vazhdim nga vitet e mëparshme por nuk kanë plan menaxhimi sipas përcaktimeve në ligj, nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, nuk janë hartuar plane menaxhimi edhe pse AdZM, ka venë në dijeni ministrinë.</p>	18-22	E LARTË	<p>Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë në bashkëpunim me AKZM dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit, të marrin masa për garantimin e planeve të menaxhimit sipas përcaktimeve në ligj, si dhe në çdo rast kontratat e nënshkruara me të tretët të jenë në përputhje me memo dhe urdhrat e Titullarit”.</p>
2.	<p>Në zonat e mbrojtura ushtrojnë aktivitet individ privat banorë të zonës si dhe një numër i konsiderueshëm biznesesh, që shfrytëzojnë këto burime fitimprurëse. Nga AdZM ka evidentim dhe regjistrim të subjekteve të biznesit të cilat kryejnë veprimtari të ndryshme me karakter ekonomik dhe social si</p>			<p>Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë, në bashkëpunim me AKZM Tiranë, të kërkojë pranë Ministrisë së Linjës për krijimin e urave lidhëse me Njësitë e Qeverisjes Vendore, që të jetë pjesë e paketës fiskale të qeverisë apo e Bashkive dhe taksa specifike për shfrytëzimin e peizazhit natyror të ZM, si burim të ardhurash, për AKZM dhe AdZM</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË ADMINISTRATEN E ZONAVE TË MBROJTURA LEZHË

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<p>bujqësi , kulturore, dhe shërbimet turistike.Nuk ka të dhëna për to në lidhje me aktivitetet e tyre (licencimi,koha e ushtrimit të aktivitetin, mendime, territoret apo dhe veprimtaritë e të cilëve përfshihen në zonën e mbrojtur ose në atë buferike) në kundërshtim me neni 9 pika 5i ligjet nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”.</p> <p>-Nga Qeveria Qendrore dhe Pushteti Vendor nuk është zgjidhur problem i taksimit specifik të personave fizik dhe juridik që shfrytëzojnë vlerat natyrore, historike dhe kulturore të zonave të mbrojtura, nëpërmjet përfshirjes së tyre në paketat fiskale të tyre.</p>			<p>rajonale për krijimin e fondeve për mirëmbajtjen dhe ushtrimin e funksioneve të monitorimit e menaxhimit të zonave të mbrojtura.</p>
3.	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se, nga 9 subjekte që kanë lidhur kontratë qiraje me Administratën e Zonave të Mbrojtura Lezhë, asnjëra prej tyre nuk ka dorëzuar pranë AdMZ Lezhë raportet e vet monitorimit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim të ligjit Nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura.</p>			<p>Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë të ndjekë të gjitha rrugët ligjore dhe ti propozojë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, zgjidhjen e kontratave për subjektet që nuk dorëzojnë pranë AdZM raportet e vetmonitorimit.</p>
4.	<p>Nga auditimi i raporteve vjetore të menaxhimit të gjendjes dhe problematikave të dala në Administratën e Zonave të Mbrojtura Lezhë u konstatua se nuk është bërë analizë faktoriale në mënyrë të detajuar si dhe nuk janë përcaktuar rrugët për zgjidhjen e tyre, nëpërmjet masave konkrete dhe vendosjen e urave të bashkëpunimit konkret me institucionet përgjegjëse. Mungon mbështetja institucionale në nivel ministror për përgatitjen e projekt-drafteve të udhëzimeve dhe marrëveshjeve të përbashkëta me institucionet e licencimit dhe që kanë tagrin e dhënies të lejeve për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, për zvogëlimin e</p>			<p>Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë të marrë masa që në raportet e vjetore të veprimtarisë dhe të gjendjes së ZM, të trajtohen në mënyrë sa më të detajuar problematikat e shfaqura në ruajtjen dhe mbrojtjen e burimeve natyrore si dhe të jepen rrugët konkrete dhe të propozojë plan-masat për ruajtjen dhe rimëkëmbjen e tyre. Këto raporte të bëhen publike dhe të bëhen të njohura dhe në Bashkinë Lezhë.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË ADMINISTRATEN E ZONA VE TË MBROJTURA LEZHË

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	veprimtarive të paligjshme.			

I.3. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Mbështetur në standardet e INTOSAI-t, Manualit të Përputhshmërisë, Manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, nga auditimi tematik i kryer në Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë, rezultoi se niveli i zbatimit të rekomandimeve plotësisht, është në nivelin 63 %. Rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm janë pranuar plotësisht, ku për përmirësimin e gjendjes janë lënë 16 gjithsej. Nga të cilat 10 janë zbatuar, 4 masë pjesërisht dhe 2 masa nuk janë zbatuar.

I. HYRJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi në Administratën e Zonave të Mbrojtura Lezhë, “Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar për periudhën 2022-2023”, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me: verifikimin e respektimit të afatit 20-ditor dhe 6-mujor për kthim përgjigje mbi përgatitjen e plan-veprimit dhe informacionin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve; verifikimin e nivelit të zbatimit të masave për përmirësim ligjor, organizative dhe të ardhura të munguara.

Sipas Programit të Auditimit, nr. 656 datë 17.07.2023, auditimi u krye nga grupi auditues, si vijon:

1. V. B., Përgjegjës Grupi
2. Sh. H., auditues

1. Objektivat e auditimit

Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme, procedurave për ndjekjen dhe dokumentimin e zbatimit të tyre, mbi zbatimin e afatit 20 ditor dhe 6 mujor të kthimit të përgjigjes, si dhe mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e zbatimit të rekomandimeve.

2. Qëllimi i auditimit

Të vlerësojë dhe evidentojë masat e marra nga subjektet përkatëse për zbatimin e rekomandimeve, hartimin e matricave (plan veprimi ose masash) për zbatimin e rekomandimeve. Të vlerësojë aktet administrative përkatëse (urdhrat) të nxjerra për zbatimin e rekomandimeve. Të vlerësojë dokumentacionin që shoqëron dhe vërteton zbatimin e rekomandimeve, si dhe të verifikojë nxjerrjen e vendimeve për fillimin e procedurave administrative për dhënien e masave disiplinore dhe pasqyrimin në dosjen personale të punonjësve. Të verifikojë dhe dokumentojë me kujdes nëse janë ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ato ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin e shpërblimit të dëmit ekonomik ose gjobave të vendosura.

3. Identifikimi i çështjes

Projekt Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Administratës e Zonave të Mbrojtura Lezhë dhe përgjegjësive, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË ADMINISTRATEN E ZONAVE TË MBROJTURA LEZHË

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Administratës e Zonave të Mbrojtura Lezhë, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e objektiv e profesional mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI.

6. Kriteret e vlerësimit

Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikën, është pasur si kriter vlerësues në radhë të parë:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Rregullorja e Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, e ndryshuar me Vendimin nr.107, datë 08.09.2017 të Kryetarit Të KLSH-së.
- Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe regjistri elektronik institucional, miratuar me Vendimin nr.67, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së.

7. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar, si rrjedhojë edhe Projekt Raporti i Auditimit është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, Rregullores së Procedurave të Auditimit, Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

8. Metodologjia e auditimit

1. Auditim i plotë sipas cilësimeve të bëra në drejtimet e auditimit.
2. Verifikimi i Urdhrëve, Udhëzimeve dhe çdo dokumenti ligjor të nevojshëm për zbatimin e rekomandimeve.

9. Dokumentimi i auditimit

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar është përgatitur Projektraporti i Auditimit, i cili do të jetë materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit për ridëgimin e rekomandimeve.

III. PËRSHKRIMI I I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Agjencinë Administratës e Zonave të Mbrojtura Lezhë, është e organizuar dhe funksionon në bazë të VKM-së, nr.102 datë 04.02.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura”, me ligjin nr. 81/2017 datë 04.05.2017, “Rregulloren e funksionimit të Administratës” dhe akteve të nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm .

2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr. 154/2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË ADMINISTRATEN E ZONAVE TË MBROJTURA LEZHË

1.Hartimi i plan-veprimet dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 gërma (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi u konstatua se:

- Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 1275/5 prot, datë 30.03.2022,ka dërguar në Administratën e Zonave të Mbrojtura Lezhë Raportin Përfundimtar të Auditimit së bashku me rekomandimet përkatëse.

- Nga Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë nuk janë marrë masa për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 15, gërma j.

Nga ana e Administratës së Zonave të Mbrojtura Lezhë nuk është kthyer përgjigje brenda 20 ditëve për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 gërma (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

- Nga ana e Administratës së Zonave të Mbrojtura Lezhë nuk janë marrë masa për respektimin e afatit prej 6 (gjashtë) muajsh për raportimin në KLSH me anë të një informacioni të hollësishëm për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim me Ligjin nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 30, pika 2.

Niveli i pranimit dhe statusi sipas llojit të rekomandimit në numër dhe në vlerë

Nga ana e KLSH janë lënë **16 rekomandime** gjithsej, nga këto:

- **16 masa organizative**, nga të cilat 10 janë zbatuar, 4 masë pjesërisht dhe 2 masa nuk janë zbatuar.

Pasqyra e realizimit të detyrave të rekomanduara paraqitet si me poshtë:

Nr	Emërtimi	Rekomandimet ne numër :				Nga rekomandimet gjithsej: Sa me dëme ekonomike							
		Rekomandim gjithsej	Nga rekomandimet janë:			Rekomanduar Gjithsej	Nga rekomandimet janë:						
			Zbatuar	Në pjesërisht	Pa zbatuar		Zbatuar arkëtuar		Zbatuar pjesërisht		Pa zbatuar		
							Nr. per	Në mijë/lek	Nr. per	Në mijë/lek	Nr. pers	Në mijë/lek	Nr. pers
1.	Masa organizative	16	10	4	2	0	0	0	0	0	0	0	0
	Totali	16	10	4	2	0	0	0	0	0	0	0	0

2.2.Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht,sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar, subjekti nuk ka rekomandim për mirësime në legjislacionin.

Duke qenë se nuk nga auditimi i mëparshëm i KLSH nuk janë lënë rekomandime për përmirësime ligjore atëherë kjo pikë e programit ezaurohet me këtë shënim.

2.3.Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË ADMINISTRATEN E ZONAVE TË MBROJTURA LEZHË

A: MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontributit për vjeljen e të ardhurave konstatojmë se ato përfaqësohen nga: Të ardhura në vlera jo të lartai 8 kontratave të përkohshme me afat 1-vjecare më të drejtëpërsëritje. Hyrje në një pikë kalim të vizitorëve në Zonat e Mbrojtura. Nga Ministria e Linjës dhe AKZM nuk janë miratuar tarifa për vjeljen e të ardhurave nga vizitorët në pikat turistikedhe monumentet natyrore me vlera historike dhe kombëtare. Gjithashtu mungon infrastruktura për ngritjen e pikave të kalimit të vizitorëve, pasi ka disa rrugë hyrëse në një pikë turistike. Nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk është zgjidhur, problemi i vendosjes së infrastrukturës së nevojshme dhe gjetjen e rrugëve dhe mjeteve për realizimin e të ardhurave, nga institucionet që menaxhojnë zonat e mbrojtura në kundërshtim me VKM nr.102 datë 04.02.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura” Kreu III pika 2, me ligjin nr. 81/2017 datë 04.05.2017, neni 17 pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.1faqe9-16 të Raportit përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë në bashkëpunim me AKZM Tiranë, të kërkojë pranë Ministrisë së Linjës për përcaktimin e vendosjen e pikave të kalimit në pjesët turistike të Zonave të mbrojtura, si dhe të japë kontributin e saj në hartimin e projekt-drafteve për miratimin e tarifave vizitore që do të përdoren për vjeljen e të ardhurave nga turistët vizitorë të ZM.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. Në territorin e ZM-vë Qarkut Lezhë është një postoblok elektronik në “Vain” i cili është funksional dhe bën të mundur hyrjen e vizitorëve dhe mjeteve nëpërmjet aksit të kontrolluar. Përveç sigurimit të të ardhurave ndihmon edhe ruajtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të zonës.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Në zonat e mbrojtura ushtrojnë aktivitet individ privat banorë të zonës si dhe një numër i konsiderueshëm biznesesh, që shfrytëzojnë këto burime fitimprurëse. Nga AdZM ka evidentim dhe regjistrim të subjekteve të biznesit të cilat kryejnë veprimtari të ndryshme me karakter ekonomik dhe social si bujqësi , kulturore, dhe shërbimet turistike. Nuk ka të dhëna për to në lidhje me aktivitetet e tyre (licencimi, koha e ushtrimit të aktivitetin, mendime, territoret apo dhe veprimtaritë e të cilëve përfshihen në zonën e mbrojtur ose në atë buferike) në kundërshtim me neni 9 pika 5i ligjet nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”.-Nga Qeveria Qendrore dhe Pushteti Vendor nuk është zgjidhur problem i taksimit specifik të personave fizik dhe juridik që shfrytëzojnë vlerat natyrore, historike dhe kulturore të zonave të mbrojtura, nëpërmjet përfshirjes së tyre në paketat fiskale të tyre.” *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3,faqe9-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë, në bashkëpunim me AKZM Tiranë, të kërkojë pranë Ministrisë së Linjës për krijimin e urave lidhëse me Njësitë e Qeverisjes Vendore, që të jetë pjesë e paketës fiskale të qeverisë apo e Bashkive dhe taksa specifike për shfrytëzimin e peizazhit natyror të ZM, si burim të ardhurash, për AKZM dhe AdZM rajonale për krijimin e fondeve për mirëmbajtjen dhe ushtrimin.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. Subjektet që ushtrojnë aktivitetin e tyre me kontratë qiraje brenda territorit të zonave të mbrojtura paguajnë detyrimet e tyre në mbështetje të VKM-së nr 1156, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e të ardhurave të gjeneruara nga tarifat që paguhet në zonat e mbrojtura, të masës dhe kritereve të përdorimit të tyre .

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË ADMINISTRATEN E ZONAVE TË MBROJTURA LEZHË

3. Gjetje nga auditimi: Në Administratën e Zonave të Mbrojtura Lezhë, nuk dispononin udhëzimet përkatëse për përcaktimin e aktorëve pjesëmarrës dhe procedurave që duhen ndjekur për peshkimin në kuadër të menaxhimit të ujërave burime natyrore. Kështu funksionimi i inspektimit të peshkimit në ZM, duhet të përcaktohet edhe nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Ndërsa në kontratën e lidhur në mes Ministrisë së Bujqësisë dhe Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit, është parashikuar që inspektimin e kryen me mjetet e veta Organizata e Menaxhimit të Peshkimit, gjë e cila është në konflikt interesi, pasi kjo organizatë nuk mund të kontrollojë aktivitetin e vet. Përjashtimi nga kontrata e Ministrisë së Mjedisit dhe AdZM ka sjellë mos kontrollin dhe mos parandalimin e peshkimit të paligjshëm, duke shmangur rolin mbrojtës të AdZM në ruajtjen Kune-Vain ,Tale dhe Shëngjin. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.81/2-017 “Për zonat mbrojtura” datë 04.05.2017 neni 34 ,pika 1,2.(*Më hollësisht trajtuar në pikën 3,faqe28-42të Raport Përfundimtarë të Auditimit*)

4.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit e Turizmit dhe Ministrinë e Bujqësisë të hartojnë një marrëveshje të përbashkët për kontrollin dhe ruajtjen e zonave të ndaluara për peshkim dhe parandalimin e peshkimit të paligjshëm në ZM.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin Administrata e Zonave të Mbrojtura Qarku Lezhë ka dërguar shkresa me nr.prot 223, datë 10.08.2022 për bashkëpunim Inspektoriatit të Peshkimit , me qëllim parandalimin dhe luftimin e peshkimit të paligjshëm në ujërat e brendshme, detare dhe bregdetare si dhe listën e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në RNM-në “Kune – Vain – Patok – Fushëkuqe – Ishëm , por deri më tani nuk kemi patur një përgjigje nga ana e tyre.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

5.Gjetje nga auditimi: Në zonat e mbrojtura Lezhë, flora dhe fauna është e kërcënuar për vetë faktin se brenda zonave të mbrojtura jetojnë një numër i lartë banorësh, që me aktivitetin e tyre cënojnë këto vlera si dhe dëmtojnë biodiversitetin. Nga Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë mungojnë propozimet për zbatimet e masave dhe programeve për ripërtëritjen e mjediseve të dëmtuara, të shkatërruara dhe të degraduara të zonave të mbrojtura.”.(*Më hollësisht trajtuar në pikën 3,faqe28-42të Raportit Përfundimtarë të Auditimit*).

5.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë në bashkëpunim me Policinë e Shtetit , ku njëra monitoron dhe konstaton dhe tjetra procedon, për çdo kontroll të kryer në terren të merren masa që rastet e flagrancës të dokumentohen e ndëshkohen rastet e kundërvajtjeve administrative dhe shkeljeve ligjore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin Administrata e Zonave të Mbrojtura Qarku Lezhë me shkresë nr.43,44,45 prot., datë 02.03.2022 ka hartuar një plan bashkëpunimi për vitin 2022 me komisaritet Lezhë, Kurbin dhe Mirditë me qëllim kontrollin dhe monitorimin i të gjithë veprimtarive që zhvillohen brenda territorit të ZM-së .

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

6. Gjetje nga auditimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë ka të evidentuar ndërtimet pa leje të kryera në ZM të Qarkut Lezhë, por nuk ishin raportuar pranë AKZM Tiranë. Nga informacioni i marrë nga zyra e ASHK Lezhë, rezulton se ka pasur një numër të ndërtimeve pa leje dhe vetë deklarimeve për legalizim. Për këtë arsye në disa zona aty ku ka pasur edhe një dendësi të lartë të ndërtimeve është vepruar duke i shpallur Zona Informale.Këto legalizime janë bërë në mungesë të planit të menaxhimit të zonës të aprovuar në kundërshtim me ligjin nr. 81/2017,“Për zonat e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË ADMINISTRATEN E ZONAVE TË MBROJTURA LEZHË

mbrojtura” neni 19 “Përdoruesit e zonave të mbrojtura” dhe Neni 25 “Veprimtaritë në zonat e mbrojtura” ligjin nr. 2020/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësive në Republikën e Shqipërisë” për parandalimin e ndërtimeve informale. Veprime në kundërshtim me nenin nr.9 pika (ç) dhe (f) të ligjit Nr.81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1,faqe 39-41 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).

6.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë në sinkronizim me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura Tiranë të vendosi ura lidhëse me Policinë e Shtetit dhe IKMT Bashkiake, për marrjen e të dhënave për ndërtimet informale dhe të kryejë verifikimin e tyre në terren. Gjithashtu të vendosi korrespondencë zyrtare me ASHK-n Lezhë, për shkëmbimin e informacionit për dosjet e ndërtimeve pa leje të shtrira në ZM që janë në proces legalizimi e hipotekimi, me qëllim parandalimin e legalizimit dhe prishjen e tyre në rastet kur mungon leja mjedisore e aprovuar.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin AdZM Qarkut Lezhë i është drejtuar me shkresë me nr.prot. 288, datë 30.11.2022 Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Drejtorisë Vendore Lezhë në lidhje me ndërtimet informale që janë në proces legalizimi apo hipotekimi dhe akoma nuk është kthyer përgjigje.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar në Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë u konstatua se për periudhën objekt auditimi janë kryer inventarët e viteve 2019 dhe 2020, por ende nuk është kryer inventari i vitit 2021, për këtë në AdZM nuk ka ardhur urdhër për kryerjen e inventarit të vitit 2021 nga AKZM, ky veprim është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12. 2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve” pikat 73,74. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1faqe23-24 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).

7.1.Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë, të marrë masa për kryerjen e inventarëve brenda afateve të përcaktuara në respektim të kriterëve dhe kërkesave ligjore, me qëllim kontrollin e menaxhimin e aktiveve të njësisë, për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të tyre dhe pasqyrimin e drejtë të gjendjes në pasqyrat financiare brenda afateve ligjore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. AdZM Qarkut Lezhë ka kryer inventarin për vitin 2022, për periudhën në vazhdim do ta kryej brenda afateve dhe kërkesave ligjore.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për secilin automjet dhe për çdo muaj rezulton se në disa raste sasia e furnizuar nuk përputhet me sasinë e harxhuar, por ishte më e lartë sasia e harxhuar me sasinë e dokumentuar në dokumentet autorizues, financiar dhe mbështetës të bashkëlidhur praktikave të konsumit të karburantit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve” pikat 34. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2,faqe23-24 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).

8.1.Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në bashkëpunim me Administratën e Zonave të Mbrojtura Lezhë, të marrin masa për planifikimin e shpenzimeve të karburantit referuar volumit të punës, nevojave reale dhe normativave të harxhimit për çdo mjet me qëllim realizimin e objektivave dhe përdorimin me efektivitet të aktiveve.



KONTROLLI I LARTË I SHPETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË ADMINISTRATEN E ZONAVE TË MBROJTURA LEZHË

-Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në bashkëpunim me Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë të analizojnë trendin në rritje të konsumit të karburantit duke e ballafaquar me volumin e punës, inspektimet, etj, duke e argumentuar rritjen e shpenzimeve me qëllim përdorimin me efektivitet dhe mundësimin e kryerjes së punës brenda limiteve ligjore të miratuara.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin AdZM Qarkut Lezhë gjatë kësaj periudhe në përmbushje të objektivave dhe aktiviteteve të programuara sasia e harxhuar e karburantit është në përputhje me sasinë e furnizuar sipas llojeve të automjeteve .

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar .

9.Gjetje nga auditimi:Nga auditimi u konstatua që për periudhën objekt auditimi përkatësisht viti 2019-2020 dhe viti 2021, Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë nuk ka të planifikuar Plan Menaxhimi. Për vitin 2019 Ministria ka përgatitur Plan Menaxhimi pasi ka qënë e përfshirë në Planin e Menaxhimit të zonës Kënetore të Kune Vainit për periudhën 2010-2019 të përgatitur dhe rishikuar në Janar të vitit 2010.

Në kundërshtim kjo me nenin 42,pika 1 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3.2,faqe44-55 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit*).

9.1.Rekomandimi:Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë në sinkron me AKZM Tiranë të kërkojnë pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, përsheptimin e miratimit të planeve të menaxhimit, për zonat e mbrojtura, për sigurimin e ruajtjes dhe mirë menaxhimit të tyre,me përfshirjen e të gjithë aktorët që janë pjesë dhe shfrytëzojnë burimet natyrore dhe vlerat kulturore,historike të ZM për 10- vjeçarin e ardhshëm.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin: Planet e Menaxhimit janë në proces rishikimi dhe hartimi nga ana e AKZM-së.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht .

10. Gjetje nga auditimi:Nga auditimi i administrimit të Zonës së Mbrojtur Lezhë konstatohet se institucionet si Drejtoria e Shërbimit Pyjor Lezhë; Bashkia Kurbin administrojnë të dhënat e viteve 1980 për nënzonat e ZM-ve me emërtimin ekonomi pyjore-kullosore.Në këtë databasë nuk ka të dhëna për sipërfaqet ujore. Gjithashtu regjistri elektronik i ZM nuk është real,pasi nuk ka të azhurnuar të dhënat e përditësuar për ndryshimet e ndodhura në sipërfaqet territoriale nën juridiksionin administrativ. Nuk ka përpunim të hartave të territoreve dhe zonimet e brendshme. Nuk ka të dhëna për ekosistemet pyjore që do të inventarizohen dhe mbarështohen, për përditësimin periodik të inventarit kombëtar të pyjeve, për hartografinë dhe dixhitalizimin e njësive të mbarështimit.(*Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1,faqe40-41 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit*).

10.1.Rekomandimi:Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë me mbështetjen e AKZM-së, të bashkërendojë punën dhe të krijojë korrespondencë zyrtare me ZRPPP, Njësitë Vendore e strukturave të tjera përkatëse, për saktësimin dhe azhurnimin e përditësimeve të dhënave e sipërfaqeve të ZM si dhe përpunimin e hartave të shtrirjes dhe zonimit sipas kategorive si dhe përcaktimin e kufijve të zonave dhe territoreve në pronësi apo në përdorim të njësive vendore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË ADMINISTRATEN E ZONAVE TË MBROJTURA LEZHË

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin .Sipas VKM-së nr.60, datë 26.01.2022 “Për Shpalljen e Ekosistemeve Natyrore Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror (Kategoria Iv), si dhe Miratimin e Ndryshimit të Statusit e të Sipërfaqeve Ekzistuese të Zonave të Mbrojtura Mjedisore, që i Përkasin Kësaj Kategorie, janë të azhornuara sipas hartave dhe zonimeve përkatëse.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

11.Gjetje nga auditimi:Nga auditimi u konstatua se 8 procesverbale konstatimi rezultojnë të jenë pa autorë, konkretisht:

- Procesverbal i mbajtur në datë 07.03.2019;
- Procesverbal imbajturnë datë 14.06.2019;
- Procesverbal i mbajtur në datë 16.1.2020 në zonën e mbrojtur Patok;
- Procesverbal i mbajtur në datën 18.1.2020,në zonën e mbrojtur Patok- Fushë Kuqe;
- Procesverbal i mbajtur në datë 09.4.2020,në zonën e mbrojtur Kune;
- Procesverbal i mbajtur në datë 05.06.2020 në zonën pyjore Fushë Kuqe;
- Procesverbal i mbajtur në datë 11.10.2020 në zonën e mbrojtur Patok- Fushe Kuqe;
- Procesverbal i mbajtur në datë 24.11.2021 në zonën e mbrojtur Kune-Vain-Tale.

Sa më sipër është vepruar në kundërshtim të ligjit Nr. 81/2017 “Për Zonat e mbrojtura”.(Më hollësisht trajtuar në pikën 3,faqe21-40 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).

11.1.Rekomandimi:Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë në bashkërendim me Inspektoratin e Policisë Pyjore të marrë masa për të zbuluar dhe ndëshkuar,rastet e dëmtimit, pushtimit, shpërdorimit, tjetërsimit, shkretimit dhe degradimit të zonave të mbrojtura brenda territorit të tyre”.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. Të gjitha raste e kundravajtjeve të konstatuara në terren gjatë viti 2022-2023 janë denoncuar në komisaritet policisë Lezhë, Kurbin dhe Mirditë.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar .

12.Gjetje nga auditimi:Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se, nga 9 subjekte që kanë lidhur kontratë qiraje me Administratën e Zonave të Mbrojtura Lezhë, asnjëra prej tyre nuk ka dorëzuar pranë AdMZ Lezhë raportet e vet monitorimit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim të ligjit Nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura”.(Më hollësisht trajtuar në pikën 4,faqe55-57 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).

12.1.Rekomandimi:Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë të ndjekë të gjitha rrugët ligjore dhe ti propozojë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, zgjidhjen e kontratave për subjektet që nuk dorëzojnë pranë AdZM raportet e vetmonitorimit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. Të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitetin e tyre me kontratë qiraje brenda territorit të zonave të mbrojtura janë njoftuar me shkresë nr.80 prot., datë 21.03.2023 nga punonjësit e AdZM-së për të dorëzuar raportet e vetmonitorimit që deri më tani nuk i kanë sjellur.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht .

13. Gjetje nga auditimi:Nga auditimi u konstatua se Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë nuk ka të dokumentuar bashkëpunimin me organet ligjzbatuese si; inspektoratin e ndërtimit, inspektoratin e peshkimit, bordet e kullimit, agjencinë rajonale të mjedisit, veprime në kundërshtim me rregulloren e brendshme të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura“Për organizimin dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË ADMINISTRATEN E ZONAVE TË MBROJTURA LEZHË

funksionimin të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratës rajonale të zonave të mbrojtura”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 44-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë të marrë masat e duhura ligjore dhe organizative që në bashkëpunim me organet e tjera ligjzbatuese të ndalojnë procesin e degradimit dhe veprimtaritë e paligjshme brenda zonave të mbrojtura Lezhë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. AdZM Qarkut Lezhë të gjitha ndërtimet që janë brenda territorit të zonave të mbrojtura ndër vite i ka të dokumentuar dhe të raportuara me shkresë nr.304 datë 20.12.2022 pranë IKMT-së Dega Rajonale Lezhë .

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar

14.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë zhvillon kontrole dhe monitorime të Monumenteve të Natyrës në të 3 rrethet Lezhë, Kurbin dhe Mirditë. Objektivi kryesor i monitorimeve është promovimi i këtyre MN-ve tek turistët që shprehin interes për vizitimin e këtyre objekteve natyrore me vlera të larta turistike. Për rrethin e Lezhës janë: Ishulli i Kunes, Rera e Hedhun, Pylli rreth kishës së Shën Eufemisë , Lisi i Markatomajve. Në rrethin Kurbin: Gryka e Shkopetit, Shpella e Shena Vlashit, Ishulli i Cabokut, Burimi i Vinjollit, Plepi i Bardhë, Gështenja e Vjetër, Rrapi i Daullës. Në rrethi Mirditë : Kroj Bardhe, Shpella e Pashës, Guri i Gjonit, Guri i Nuses. Nga këto monumente të natyrës AdZM Lezhë nuk merr të ardhura, nga vizitorët drejt tyre.

14.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë në bashkëpunim me Ministrinë e Linjës, ti japi prioritet promovimit të Monumenteve të Natyrës, si burim i të ardhurave, si dhe gradualisht të bëhet e mundur vënia në efikasitet e tyre duke propozuar tarifa specifike.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 28-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin Në territorin e Qarkut Lezhë janë gjithsej 39 monumente natyre që janë të shpërndara sipas rretheve Lezhë 10, Mirditë 17, Kurbin 12. Një pjesë e këtyre monumenteve janë brenda territorit të Zonave të mbrojtura dhe një pjesë jashtë tyre. Objektivi kryesor i monitorimeve është promovimi i tyre tek turistët që shprehin interes për vizitimin e këtyre objekteve natyrore me vlera të larta bio natyrore dhe turistike. Të gjithë këto monumente vizitohen nga turistë vendas dhe të huaj pasi secili prej tyre ka karakteristikat e tij të veçanta.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raporteve vjetore të menaxhimit të gjendjes dhe problematikave të dala në Administratën e Zonave të Mbrojtura Lezhë u konstatua se nuk është bërë analizë faktoriale në mënyrë të detajuar si dhe nuk janë përcaktuar rrugët për zgjidhjen e tyre, nëpërmjet masave konkrete dhe vendosjen e urave të bashkëpunimit konkret me institucionet përgjegjëse. Mungon mbështetja institucionale në nivel ministror për përgatitjen e projekt-drafteve të udhëzimeve dhe marrëveshjeve të përbashkëta me institucionet e licencimit dhe që kanë tagrin e dhënies të lejeve për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, për zvogëlimin e veprimtarive të paligjshme. Këto raporte depozitohen pranë AKZM, por nuk publikohen dhe nuk i dërgohen Bashkisë Lezhë, në kundërshtim me nenin 30 “Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura” të rregullores të brendshme të organizimit dhe funksionimit të AKZM dhe ADZM të miratuar, më



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË ADMINISTRATEN E ZONAVE TË MBROJTURA LEZHË

datë 21.09.2015. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 28-42 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).

15.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë të marrë masa që në raportet e vjetore të veprimtarisë dhe të gjendjes së ZM, të trajtohen në mënyrë sa më të detajuar problematikat e shfaqura në ruajtjen dhe mbrojtjen e burimeve natyrore si dhe të jepen rrugët konkrete dhe të propozojë plan-masat për ruajtjen dhe rimëkëmbjen e tyre. Këto raporte të bëhen publike dhe të bëhen të njohura dhe në Bashkinë Lezhë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjektaudituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar

16. Gjetje nga auditimi: Në Administratën e Zonave të Mbrojtura Lezhë janë kryer takime me banorët takime këshilluese informuese, ekzistojnë e-mail si ftesa për takime, trajnime si dhe për programet dhe axhendat e tyre të zhvillimit, por nuk ka dokumentacion shkresor evidentues për lënien e gjurmës së auditimit, që vërteton kryerjen e këtyre veprimtarive (takime), veprime në kundërshtim me “Rregulloren e brendshme për organizmin dhe funksionimin’ e AdZM”, neni 30 pika 1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.2, faqe 57-60 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).

16.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë, të marrë masa që në çdo takim të kryer në terren me banorët apo te interesuar siç janë organizata të ndryshme për zhvillimin e zonave të mbrojtura ti evidentojnë nëpërmjet informacioneve ose procesverbaleve për lënie gjurme sipas rregulloreve të brendshme.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin Në raportimet mujore AdZM Qarkut Lezhë i ka të raportuar te gjitha takimet apo aktivitetet e zhvilluara me aktorë të ndryshëm .

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht .

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

Për përmirësimin e punës në të ardhmen, rekomandojmë:

A. MASA ORGANIZATIVE

Nga auditimi i mëparshëm I Kontrolli të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 1275/5 prot, datë 30.03.2022, ka dërguar në Administratën e Zonave të Mbrojtura Lezhë Raportin Përfundimtarë të Auditimit së bashku me rekomandimet përkatëse.

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer konstatohet se në tre raste ishin miratuar kontrata në kundërshtim me memon e hartuar nga drejtoria e projektit AKZM, ku theksohet se vend grumbullimi i mbetjeve urbane që mundë të gjenerohen gjatë zhvillimit të veprimtarisë dhe mënyrën e largimit tyre nga zona e mbrojtur të bëhet sipas një grafiku të miratuar respektivisht nga AdZM Lezhë dhe Bashkia përkatëse.

-Në vitin 2021 janë lidhur 4 kontrata të cilat janë në vazhdim nga vitet e mëparshme por nuk kanë plan menaxhimi sipas përcaktimeve në ligj, nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, nuk janë hartuar plane menaxhimi edhe pse AdZM, ka venë ne dijeni ministrinë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet 7-7 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË ADMINISTRATEN E ZONAVE TË MBROJTURA LEZHË

2.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë në bashkëpunim me AKZM dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit,të marrin masa për garantimin e planeve të menaxhimit sipas përcaktimeve në ligj, si dhe në çdo rast kontratat e nënshkruara me të tretët të jenë në përputhje me memo dhe urdhrat e Titullarit”.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3.Gjetje nga auditimi:Në zonat e mbrojtura ushtrojnë aktivitet individ privat banorë të zonës si dhe një numër i konsiderueshëm biznesesh, që shfrytëzojnë këto burime fitimprurëse. Nga AdZM ka evidentim dhe regjistrim të subjekteve të biznesit të cilat kryejnë veprimtari të ndryshme me karakter ekonomik dhe social si bujqësi , kulturore, dhe shërbimet turistike.Nuk ka të dhëna për të lidhje me aktivitetet e tyre (licencimi,koha e ushtrimit të aktivitetin, mendime, territoret apo dhe veprimtaritë e të cilëve përfshihen në zonën e mbrojtur ose në atë buferike) në kundërshtim me neni 9 pika 5i ligjet nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”.

-Nga Qeveria Qendrore dhe Pushteti Vendor nuk është zgjidhur problem i taksimit specifik të personave fizik dhe juridik që shfrytëzojnë vlerat natyrore, historike dhe kulturore të zonave të mbrojtura, nëpërmjet përfshirjes së tyre në paketat fiskale të tyre. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 7-7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi:Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë,në bashkëpunim me AKZM Tiranë, të kërkojë pranë Ministrisë së Linjës për krijimin e urave lidhëse me Njësitë e Qeverisjes Vendore, që të jetë pjesë e paketës fiskale të qeverisë apo e Bashkive dhe taksa specifike për shfrytëzimin e peizazhit natyror të ZM, si burim të ardhurash, për AKZM dhe AdZM rajonale për krijimin e fondeve për mirëmbajtjen dhe ushtrimin e funksioneve të monitorimit e menaxhimit të zonave të mbrojtura.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

9.Gjetje nga auditimi:Nga auditimi u konstatua që për periudhën objekt auditimi përkatësisht viti 2019-2020 dhe viti 2021, Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë nuk ka të planifikuar Plan Menaxhimi. Për vitin 2019 Ministria ka përgatitur Plan Menaxhimi pasi ka qënë e përfshirë në Planin e Menaxhimit të zonës Kënetore të Kune Vainit për periudhën 2010-2019 të përgatitur dhe rishikuar në Janar të vitit 2010.Në kundërshtim kjo me nenin 42,pika 1 . *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet 7-8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1.Rekomandimi:Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë në sinkron me AKZM Tiranë të kërkojnë pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, përsheptimin e miratimit të planeve të menaxhimit, për zonat e mbrojtura, për sigurimin e ruajtjes dhe mirë menaxhimit të tyre,me përfshirjen e të gjithë aktorët që janë pjesë dhe shfrytëzojnë burimet natyrore dhe vlerat kulturore,historike të ZM për 10- vjeçarin e ardhshëm.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

12.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se, nga 9 subjekte që kanë lidhur kontratë qiraje me Administratën e Zonave të Mbrojtura Lezhë, asnjëra prej tyre nuk ka dorëzuar pranë AdMZ Lezhë raportet e vet monitorimit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim të ligjit Nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 8-8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1.Rekomandimi:Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë të ndjekë të gjitha rrugët ligjore dhe ti propozojë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, zgjidhjen e kontratave për subjektet që nuk dorëzojnë pranë AdZM raportet e vetmonitorimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË ADMINISTRATEN E ZONAVE TË MBROJTURA LEZHË

Menjëherë dhe në vazhdimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raporteve vjetore të menaxhimit të gjendjes dhe problematikave të dala në Administratën e Zonave të Mbrojtura Lezhë u konstatua se nuk është bërë analizë faktoriale në mënyrë të detajuar si dhe nuk janë përcaktuar rrugët për zgjidhjen e tyre, nëpërmjet masave konkrete dhe vendosjen e urave të bashkëpunimit konkret me institucionet përgjegjëse. Mungon mbështetja institucionale në nivel ministror për përgatitjen e projekt-drafteve të udhëzimeve dhe marrëveshjeve të përbashkëta me institucionet e licencimit dhe që kanë tagrin e dhënies të lejeve për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, për zvogëlimin e veprimtarive të paligjshme. Këto raporte depozitohen pranë AKZM, por nuk publikohen dhe nuk i dërgohen Bashkisë Lezhë, në kundërshtim me nenin 30 “Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura” të rregullores të brendshme të organizimit dhe funksionimit të AKZM dhe ADZM të miratuar, më datë 21.09.2015. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet 8-8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë të marrë masa që në raportet e vjetore të veprimtarisë dhe të gjendjes së ZM, të trajtohen në mënyrë sa më të detajuar problematikave e shfaqura në ruajtjen dhe mbrojtjen e burimeve natyrore si dhe të jepen rrugët konkrete dhe të propozojë plan-masat për ruajtjen dhe rimëkëmbjen e tyre. Këto raporte të bëhen publike dhe të bëhen të njohura dhe në Bashkinë Lezhë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

16. Gjetje nga auditimi: Në Administratën e Zonave të Mbrojtura Lezhë janë kryer takime me banorët takime këshilluese informuese, ekzistojnë e-mail si ftesa për takime, trajnime si dhe për programet dhe axhendat e tyre të zhvillimit, por nuk ka dokumentacion shkresor evidentues për lënien e gjurmës së auditimit, që vërteton kryerjen e këtyre veprimtarive (takime), veprime në kundërshtim me “Rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e AdZM”, neni 30 pika 1.. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet 8-9 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë, të marrë masa që në çdo takim të kryer në terren me banorët apo te interesuar siç janë organizata të ndryshme për zhvillimin e zonave të mbrojtura ti evidentojnë nëpërmjet informacioneve ose procesverbaleve për lënie gjurme sipas rregullores së brendshme.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi

GRUPI I AUDITIMIT

1. V. B., Përgjegjës Grupi
2. Sh.H. , auditues

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

A. Z.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË ADMINISTRATA E ZONAVE TË MBROJTURA TIRANË

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK

“PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA

ADMINISTRATA E ZONAVE TË MBROJTURA TIRANË

	Përmbajtja	1-1
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	2-2
	1.Përshkrim i shkurtër Projektit të Auditimit	2-2
	2.Përshkrim i gjetjeve kryesore	2-3
	3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	3-3
II	HYRJE	3-3
	2. Qëllimi	3-3
	3. Identifikimi i çështjes	3-3
	4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	4-4
	5. Përgjegjësitë e audituesve	4-4
	6. Kriteret e vlerësimit	4-4
	7. Standardet e Auditimit	4-4
	8. Metodat e auditimit	4-4
	9. Dokumentimi i auditimit	4-4
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	4-7
1	Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	4-4
2	Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit	4-5
2.1	Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".	5-5
2.2	Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht,sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	6-7
IV.	Gjetje dhe Rekomandime	6-7

I. Përmbledhje Ekzekutive

1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (në vijim KLSH) ushtroi auditimin tematik me objekt “Mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022” në Administratën e Zonave të Mbrojtura Tiranë, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me verifikimin dhe vlerësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Gjatë auditimit në terren nga grupi i auditimit është mbajtur 1 akt-verifikim, sipas çështjeve respektive, i cili është dorëzuar në protokollin e subjektit. Në përfundim të punës në terren është kryer takimi përmblyës me përfaqësuesit e Administratën e Zonave të Mbrojtura Tiranë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË ADMINISTRATA E ZONAVE TË MBROJTURA TIRANË

I.2. Në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet më të rëndësishme të auditimit, paraqiten si më poshtë vijon:

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	<p>Nga auditimi i ushtruar u konstatua se Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë, ka burime te tjera te të ardhura te pa arkëtuara dhe te munguara në buxhetin e shtetit Të ardhura këto nga lëvizja e vizitorëve në drejtimin tjetër të portës hyrës që kalojnë “pa paguar as një detyrim në Zonën e Mbrojtur Dajt, nga lëvizja e vizitorëve “ndërmjet teleferikut “D. E” si dhe ne zonën e Karavastasë, objekteve të natyrës dhe antenat televizive te vendosura ne Zonat e Mbrojtura e nuk kanë as një plan për menaxhimin dhe rritjen e te ardhurave me Ministrinë e vartësisë duke krijuar te ardhura te munguara mesatarisht 200,000,000 lekë. (Ilogaritur sipas të dhënave të mara nga faqja e ëeb-it e D-E)</p> <p>Veprime në kundërshtim me VKM nr.881 date 14.12.2016 “Për miratimin e Planit te Përgjithshëm te Territorit” si dhe me nenin 41 (Pika 1) dhe neni 42 i ligjit nr.81/2017 “ Për Zonat e Mbrojtura</p>	7	E LARTË	<p>. Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë të ushtrojnë kontrole të vazhdueshme për arkëtimin e detyrimeve nga vizitorët që hyjnë në Zonën e Mbrojtur.</p>
2.	<p><i>Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë të ndjekë gjithë procedurat administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës 1,141,962 lekë, tarife qiraje e pa paguar, për sipërfaqet në përdorim të marra me qira në zonat e mbrojtura, nga 6 subjekte, përkatësisht: K.D 100,300 lekë, B.H 207,825 lekë, E K 90,000 lekë, A.E 32,337 lekë, A.D191,500lekë,“H“ Shpk 520,000 lekë.</i></p>	7	E MESME	<p>Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë të ndjeke gjithë procedurat administrative dhe në gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e detyrimit nga subjekti F.D për 42,700 lekë.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË ADMINISTRATA E ZONA VE TË MBROJTURA TIRANË

I.3. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Mbështetur në standardet e INTOSAI-t, Manualit të Përputhshmërisë, Manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, nga auditimi tematik i kryer në Administratën e Zonave të Mbrojtura Tiranë, rezultoi se niveli i zbatimit të rekomandimeve plotësisht, është në nivelin 81 %. Rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm 11 rekomandime gjithsej nga të cilat: janë pranuar plotësisht, ku për përmirësimin e gjendjes janë lënë 9 masa organizative, 2 masa Zhdëmtim dëmi. zbatuar plotësisht 8 rekomandime 3 rekomandime pjesërisht .

II. HYRJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi në Administratën e Zonave të Mbrojtura Tiranë “Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar për periudhën 2022-2023”, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me: verifikimin e respektimit të afatit 20-ditor dhe 6-mujor për kthim përgjigje mbi përgatitjen e plan-veprimit dhe informacionin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve; verifikimin e nivelit të zbatimit të masave për përmirësim ligjor, organizative dhe të ardhura të munguara.

Sipas Programit të Auditimit, nr. 656 datë 17.07.2023, auditimi u krye nga grupi auditues, si vijon:

1. V. B., Përgjegjës Grupi
2. Sh. H., auditues

1. Objektivat e auditimit

Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme, procedurave për ndjekjen dhe dokumentimin e zbatimit të tyre, mbi zbatimin e afatit 20 ditor dhe 6 mujor të kthimit të përgjigjes, si dhe mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e zbatimit të rekomandimeve.

2. Qëllimi i auditimit

Të vlerësojë dhe evidentojë masat e marra nga subjektet përkatëse për zbatimin e rekomandimeve, hartimin e matricave (plan veprimi ose masash) për zbatimin e rekomandimeve. Të vlerësojë aktet administrative përkatëse (urdhurat) të nxjerra për zbatimin e rekomandimeve. Të vlerësojë dokumentacionin që shoqëron dhe vërteton zbatimin e rekomandimeve, si dhe të verifikojë nxjerrjen e vendimeve për fillimin e procedurave administrative për dhënien e masave disiplinore dhe pasqyrimin në dosjen personale të punonjësve. Të verifikojë dhe dokumentojë me kujdes nëse janë ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ato ligjore në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin e shpërblimit të dëmit ekonomik ose gjobave të vendosura.

3. Identifikimi i çështjes

Projekt Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Administratës e Zonave të Mbrojtura Tiranë dhe përgjegjësive, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Administratës e Zonave të Mbrojtura Tiranë janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË ADMINISTRATA E ZONAVE TË MBROJTURA TIRANË

nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e objektiv e profesional mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI.

6. Kriteret e vlerësimit

Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikën, është pasur si kriter vlerësues në radhë të parë:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- Rregullorja e Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, e ndryshuar me Vendimin nr.107, datë 08.09.2017 të Kryetarit Të KLSH-së.
- Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe regjistri elektronik institucional, miratuar me Vendimin nr.67, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së.

7. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar, si rrjedhojë edhe Projekt Raporti i Auditimit është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, Rregullores së Procedurave të Auditimit, Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

8. Metodologjia e auditimit

1. Auditim i plotë sipas cilësimeve të bëra në drejtimet e auditimit.
2. Verifikimi i Urdhërave, Udhëzimeve dhe çdo dokumenti ligjor të nevojshëm për zbatimin e rekomandimeve.

9. Dokumentimi i auditimit

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar është përgatitur Projektraporti i Auditimit, i cili do të jetë materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit për ridërgimin e rekomandimeve.

III. PËRSHKRIMI I I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim Agjencinë Administratës e Zonave të Mbrojtura Tiranë, është e organizuar dhe funksionon në bazë të VKM-së, nr.102 datë 04.02.2015 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura", me ligjin nr. 81/2017 datë 04.05.2017, "Rregulloren e funksionimit të Administratës" dhe akteve të nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm.

2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

1. Hartimi i plan-veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 germa (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË ADMINISTRATA E ZONAVE TË MBROJTURA TIRANË

Nga auditimi u konstatua se:

- Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr.892/6 prot, datë 12.01.2023, ka dërguar në Administratën e Zonave të Mbrojtura Tiranë Raportin Përfundimtar të Auditimit së bashku me rekomandimet përkatëse.

- Nga Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë nuk janë marrë masa për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në përputhje me Ligjin nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 15, gërma j.

Nga ana e Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë nuk është kthyer përgjigje brenda 20 ditëve për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 gërma (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

- Nga ana e Administratës së Zonave të Mbrojtura Lezhë nuk janë marrë masa për respektimin e afatit prej 6 (gjashtë) muajsh për raportimin në KLSH me anë të një informacioni të hollësishëm për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim me Ligjin nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 30, pika 2.

Niveli i pranimit dhe statusi sipas llojit të rekomandimit në numër dhe në vlerë

Nga ana e KLSH janë lënë **11 rekomandime** gjithsej, nga këto:

- **9 masa organizative**, nga të cilat 8 janë zbatuar, ndërsa 1 janë zbatuar pjesërisht
- **2 masa shpërblim dëmi te cilat janë zbatuar pjesërisht.**

Pasqyra e realizimit të detyrave të rekomanduara paraqitet si me poshtë:

Nr	Emërtimi	Rekomandimet ne numër :				Nga rekomandimet gjithsej: Sa me dëme ekonomike						
		Rekomandim gjithsej	Nga rekomandimet janë:			Rekomanduar Gjithsej		Nga rekomandimet janë:				
			Zbatuar	pjesërisht	Pa zbatuar	Nr. per	Në mijë/lek	Zbatuar arkëtuar	Zbatuar pjesërisht		Pa zbatuar	
							Nr. per	Në mijë/lek	Në mijë/lek	Nr. Pjes	Në mijë/lek	
1.	Masa organizative	9	8	1	0	0	0	0	0	0	0	0
2.	Masa për përmirësim ligjor	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3.	Shpërblim demi	2	0	2	0	0	2,013,991	0	829,329	2	0	1,141,962
4.	Masa efekt financiar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Totali	11	8	3	0	0	2,013,991	0	829,329	2	0	1,184,662

2.2. Zbatimi i rekomandimeve për përmirësim në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht,sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar. Subjekti nuk ka përmirësimi në legjislacionin.

Duke qenë se nuk nga auditimi i mëparshëm i KLSH nuk janë lënë rekomandime për përmirësim ligjore atëherë kjo pikë e programit ezaurohet me këtë shënim.

2.3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË ADMINISTRATA E ZONAVE TË MBROJTURA TIRANË

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve me karakter organizativ të lëna nga KLSH, u konstatua si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar u konstatua se nga Administrata e Zonave të Mbrojtura nuk ka evidentim dhe regjistrim të subjekteve dhe individëve privatë të cilët kryejnë veprimtari të ndryshme me karakter ekonomik, social dhe shërbime turistike në zonat e mbrojtura. Nuk ka të dhëna për to në lidhje me aktivitetet e tyre (licencimi, koha e ushtrimit të aktivitetin, vendime, territoret apo dhe veprimtaritë e të cilëve përfshihen në zonën e mbrojtur ose në atë buferike) në kundërshtim me neni 9 pika 5 i ligjet nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”.

- nuk është zgjidhur problem i taksimit specifik të personave fizik dhe juridik që shfrytëzojnë vlerat natyrore, historike dhe kulturore të zonave të mbrojtura,

- Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë **nuk** ka të evidentuar dhe raportuar ndërtimet pa leje të kryera në ZM të Qarkut Tiranë dhe Lushnjë,

- ka patur shumë ndërtimeve pa leje në zonat e mbrojtura konstatuar nëpërmjet vetë deklarimeve për legalizim, gjë që ka sjellë shpalljen e tyre në Zona Informale, gjithashtu legalizimet janë bërë në mungesë të planit të menaxhimit të zonës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën faqen 15-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë dhe Lushnjë, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë e Shtetit, Bashkitë Tiranë dhe Lushnjë, Agjencinë Shtetërore të Kadastrës të kryejnë verifikimin e ndërtimeve pa leje dhe prishjen e tyre në zonat e mbrojtura si dhe vendosjen e taksave specifike për shfrytëzimin e peizazhit natyror ndaj individëve dhe bizneseve që ushtrojnë aktivitet brenda tyre.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin.Nga ana e AdZM-së Tiranë është dërguar shkresë për sjellje dokumentacioni të subjekteve informale dhe është lënë një afat për plotësimin e dosjes. Për mos përgjigje në kohë të këtyre subjekteve AdZM-ja me urdhër të brendshëm të AdZM-së Tiranë është ngritur grupi i punës për verifikimin e objekteve informale në zonë të mbrojtur Parku Kombëtar “Mali i Dajtit dhe Parku Natyror “Mali me Gropa-Bizë-Martanesh”:

- Urdhër Nr.118 Prot., datë 06.04.2023
- Urdhër Nr.125 Prot., datë 11.04.2023
- Urdhër Nr.126 Prot., datë 12.04.2023
- Urdhër Nr.142 Prot., datë 26.04.2023

Në zbatim të këtyre urdhrave të ngritur janë evidentuar për Parkun Kombëtar “Mali i Dajtit” 17 subjekte të cilat janë pa dokumentacion përkatës dhe një subjekt në Parku Natyror “Mali me Gropa-Bizë- Martanesh”.

- Me shkresë Nr.251 Prot., datë 28.07.2023 jemi drejtura Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura për ndërtimet informale në zonat e mbrojtura të qarkut Tiranë.

- Me shkresë Nr.266 Prot., datë 09.08.2023 jemi drejtura Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura “Për dhënie mendimi” për ecurinë dhe ndjekjen e mëtejshme për këto ndërtime informale

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe **i zbatuar**.

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar u konstatua se Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë ka mungesë bashkëpunimi me organet ligj zbatuese si; Inspektoratin e Mbrojtjes të Territorit, Bordet e Kullimit, Agjencinë Rajonale Mjedisore, Veprim në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura “Për organizimin dhe funksionimin të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË ADMINISTRATA E ZONAVE TË MBROJTURA TIRANË

Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratës rajonale të zonave të mbrojtura”. (Më hollësisht trajtuar në faqen 19-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë në bashkëpunim me organet ligj zbatuese të marrë masat të ndaloj veprimtaritë e paligjshme brenda zonave të mbrojtura Tiranë dhe Lushnjë. **Menjëherë**

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. AdZM-ja Tiranë gjitha procesverbalet i janë dërguar me shkresë Inspektoratin e Mbrojtjes të Territorit dhe Policisë së Shtetit si dhe Prokurorisë Rrethit Tiranë për ndjekje të mëtejshme të procedurave. Për sa i përket Bordit Kullimit AdZM-ja Tiranë është antare Këshillit Basenit dhe merr pjesë sa herë që Prefekti i qarkut Tiranë thërret mbledhje.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë nuk ka bërë analizë të detajuar duke përcaktuar dhe rrugët për zgjidhjen e tyre, nëpërmjet masave konkrete në bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse në raportin e menaxhimit të qëndrueshëm të zonës së mbrojtur paraqitur në fund të vitit si dhe këto të dhëna nuk publikohen dhe nuk i dërgohen Bashkisë Tiranë. Gjithashtu mungon mbështetja institucionale në nivel ministror për përgatitjen e projekt-drafteve të udhëzimeve dhe marrëveshjeve të përbashkëta me institucionet e licencimit dhe dhënieve të lejeve për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, me qëllim zvogëlimin e veprimtarive të paligjshme. (Më hollësisht trajtuar në faqen 57-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë marrë masa që në raportet e vjetore të veprimtarisë dhe të gjendjes së zonave të mbrojtura, të trajtohen të detajuara problematikat e shfaqura në ruajtjen dhe mbrojtjen e burimeve natyrore si dhe të jepen rrugët konkrete dhe të propozojë plan-masash për ruajtjen dhe rimëkëmbjen e tyre si dhe raporte të bëhen publike dhe të njohura dhe për Bashkinë Tiranë. **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. AdZM-ja Tiranë ka raportuar në mënyrë periodike pranë AKZM-së për të gjitha aktivitetet. Por AdZM-Tiranë kryen aktivitete takime dhe me Njësitë Administrative si dhe komuniteti, shkollat që janë brenda territorit të zonave të mbrojtura qarku Tiranë.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar u konstatua se në Administratën e Zonave të Mbrojtura Tiranë janë kryer takime me banorët takime këshilluese informuese por nuk ka dokumentacion shkresor evidentues për lënien e gjurmës së auditimit, që vërteton kryerjen e këtyre veprimtarive (takime) të cilat janë në kundërshtim me “Rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin’ e AdZM”, neni 30 pika 1. Ndërsa nuk ekzistojnë e-mail për ftesat për takime, trajnime si dhe për programet dhe axhendat e tyre të zhvillimit. (Më hollësisht trajtuar në faqe 42-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë, të marrë masa të evidentojnë dhe dokumentojë çdo takim të kryer për në terren zhvillimin e zonave të mbrojtura me banorët apo organizata të ndryshme. **Menjëherë dhe në vazhdimësi**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË ADMINISTRATA E ZONAVE TË MBROJTURA TIRANË

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin . Pas Raportit Përfundimtar të KLSH-së, AdZM-ja Tiranë ka marrë masa për evidentimin e e aktiviteteve me informacion për takimet të shoqëruara me foto raportimet janë bërë periodik javor pranë AKZM-së.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

5.Gjetje nga auditimi: Në Administratën e Zonave të Mbrojtura nuk kane dale urdhra për inventarët, dokumentacioni i inventarit është formal dhe i pa kontabilizuar saktë me diferenca ne kartelat personale sipas pasqyrave dhe të pa firmosura nga dorëzuesi dhe marsi ne dorëzim. Konkretisht rezulton se në vitin 2021 gjendja kontabilitetit është 153,647,089 lekë, pra me difference të pa kontabilizuar ne **17 artikuj në vlerë 6,319,273 lekë**, veprime te cilat janë në kundërshtim me “Rregulloren e brendshme për organizmin dhe funksionimin’ e AdZM”, neni 30 pika 1 dhe në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12. 2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve” pikat 73,74.(Më hollësisht trajtuar në faqen 7-8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë, të nxjerrë urdhra për ngritjen e komisionit dhe inventarizimin e aseve të saj. **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin .Nga ana e AKZM-së është ngritur grup pune për inventarin e aseve të AdZM-së Tiranë.

Bashkëngjitur do të kenë Urdhërin dhe inventarin e plotë të AdZM-së Tiranë.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar u konstatua se Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë ka burime te tjera te të ardhura te pa arkëtuara dhe te munguara në buxhetin e shtetit Të ardhura këto nga lëvizja e vizitorëve në drejtimin tjetër të portës hyrës që kalojnë “**pa paguar as një detyrim** në Zonën e Mbrojtur Dajt, nga lëvizja e vizitorëve “ndërmjet teleferikut “D. E” si dhe ne zonën e Karavastasë, objekteve të natyrës dhe antenat televizive te vendosura ne Zonat e Mbrojtura e nuk kanë as një plan për menaxhimin dhe rritjen e te ardhurave me Ministrinë e vartësisë duke krijuar te ardhura te munguara mesatarisht **200,000,000 lekë**. (Ilogaritur sipas të dhënave të mara nga faqja e web-it e D-E)

Veprime në kundërshtim me VKM nr.881 date 14.12.2016 “Për miratimin e Planit te Përgjithshëm te Territorit” si dhe me nenin 41 (Pika 1) dhe neni 42 i ligjit nr.81/2017 “ Për Zonat e Mbrojtura “. (Më hollësisht trajtuar në faqen 25-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1.Rekomandimi: Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë të ushtrorjnë kontrolle të vazhdueshme për arkëtimin e detyrimeve nga vizitorët që hyjnë në Zonën e Mbrojtur.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. Me shkresë nr. 228 Prot., datë 11.07.2023 AdZM-ja Tiranë është drejtuar AKZM-së për dhënie mendimi.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se **nuk janë regjistruar ne ASHK Tiranë sipërfaqet e zonave të mbrojtura** nga Administrata e zonave të mbrojtura Tiranë (ADZM), ne kundërshtim me nenin 55 “Regjistrimi i sipërfaqeve zonave mbrojtura” te ligjit 81/2017 “Për zonat e mbrojtura” (trajtuar me hollësisht ne faqet 10- të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË ADMINISTRATA E ZONAVE TË MBROJTURA TIRANË

7.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura të marrë masa për regjistrimin në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, të sipërfaqeve të zonave të mbrojtura. *Menjëherë dhe në vazhdimësi*

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se **ADZM Tirane në disa raste nuk ka kompletuar me dokumentacion të plotë dosjet e subjekteve, për sipërfaqet e marra me qira në zonat e mbrojtura**, për periudhën e viteve 2019, 2020 dhe 2021, konkretisht:

a. mandat arkëtimet janë fotokopje, ne vend te origjinaleve, madje 1 rast i palexueshme, *për likuidimin e tarifave qirasë vjetore nga subjektet, në kundërshtim me nenin 119 te Kodit Civil, me UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve njësitë sektorit publik “, pika 36.*

b. mungojnë akt verifikimet ne terren, lidhur me respektimin e ndërtimeve prej druri të çmontueshme dhe provizore, ose nëse ato kanë përbërje muri dhe beton,

c. mungojnë dokumentet që vërteton respektimin e sipërfaqes zënë, sipas kontratave lidhura,

d. mungojnë dokumentet për rehabilitimin e zonës mbrojtur ne përfundim afatit kontratave.

e. mungojnë dokumentet përfundimtare qe pasqyrojnë sipërfaqet ndërtimore te objekteve nga specialistit licencuar, kriter baze për përlllogaritjen tarifës qirasë për sipërfaqet e objekteve.

k. mungojnë dokumentet qe te shprehet pushteti vendor për këto objekte,

(Trajtuar me hollësisht ne faqet 35-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë të marrë masa për kompletimin e 20 dosjeve të subjekteve me dokumentacionin e munguar, për sipërfaqet e marra me qira në zonat e mbrojtura, për periudhën e viteve 2019, 2020 dhe 2021, në zbatim të kërkesave ligjore, përkatësisht: K.D., B.H, E.K, A.Sh, G.L, A.K, A.E, A.D, “T.E.”, “D.P.” sh.p.k, “H” sh.p.k, A. K, G.M, K.K, “F” sh.p.k, E.K, Sh.A, “S” sh.p.k, “A” sh.a, E.B.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin.Me shkresë nr. 98 Prot., datë 20.03.2023 AdZM-ja Tiranë është drejtuar AKZM-së për djekjen e procedurës për regjistrimin e pronave.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ADZM Tiranë:

a. në 3 raste, padrejtësisht është shtyre afati i kontratave nga 5 vjet në 10 vjet pa mbaruar afati 5 vjeçar i tyre, në vend që të shtyhej 3 muaj para mbarimit të afatit të kontratës 5 vjeçare, në kundërshtim me nenin 3, pika 3.1 dhe 3.2 të kontratave përkatëse, ndërsa në 1 rast nuk është miratuar shtesa e afatit kontratës, pra me 2 standarde, konkretisht:

* sipas shtesës kontratës nr. 96 datë 20.08.2021, subjekti G.M.

* sipas amendamentit 2 datë 20.10.2021, subjekti A.Sh.

* sipas amendamentit 2 datë 13.09.2021, subjekti D.P.

b. në 1 rast, pa bazë ligjore ka lidhur 4 kontrata (amendamente), në vend të 1 kontrate (2020-2021 duke ndryshuar dhe shtuar sipërfaqet me qira (nga 1,3 ha në 33,8 ha dhe 47,3 ha) në zonën e mbrojtur “Parku Kombëtar Mali Dajti”.

c. në disa raste paraqiten vonesa të amendamenteve, për pasqyrimin e ndryshimeve ligjore të tarifave qirasë vjetore, në vend që të mbahen në momentin e zbardhjes aktit ligjore, sipas VKM 1156 datë 24.12.2020, lidhja 1, që subjektet të likuidojnë detyrimet e qirasë për sipërfaqet e marra përdorim në kohen e duhur.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 40-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1. Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë:

- të respektojë kushtet e kontratave në shtyrjet e afateve 5-vjeçare të tyre dhe në raste të konstatimeve të shkeljeve të nxirren përgjegjësitë ndaj personave përgjegjës,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË ADMINISTRATA E ZONAVE TË MBROJTURA TIRANË

- të mos lidhë kontrata duke shtuar sipërfaqet në përdorim në zonën e mbrojtur të paargumentuara dhe në raste të konstatimeve të shkeljeve të nxirren përgjegjësitë ndaj personave përgjegjës,
- të marrë masa që subjektet të likuidojnë tarifën e qirasë në momentin e ndryshimeve ligjore dhe hyrjes në fuqi të tyre.

Menjëherë

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. **Për pikën a:** Ndryshimi i afati kohor të 3 kontratave është bërë me urdhër të Drejtorit Përgjithshëm dhe për këtë janë shkresat për çdo subjekt në dosje.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

B. MASA ZHDËMTIMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ADZM Tirane nuk ka përllogaritur sakte dhe nuk ka marrë masa për arkëtimin e plote të **detyrimeve për tarifën e qirasë** për sipërfaqet e zonave të mbrojtura në përdorim, për **11 subjekte** në vlerën **1,955,991 leke ardhura të munguara**, në kundërshtim me ligjin nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, me VKM nr. 1064 date 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin pyjor dhe kullotave” ndryshuar me VKM nr. 1156 datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e ardhurave gjeneruara nga tarifën që paguhen në zonat mbrojtura të masës dhe kritereve përdorimit tyre”, lidhja 1, pika 3/a/1, pika 3/b/1 dhe pika 3/c/1 etj (trajtuar më hollësisht në faqet 10-11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Tirane të ndjekë gjithë procedurat administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, për arkëtimin e vlerës **1,955,991 lekë, tarife qiraje e pa paguar**, për sipërfaqet në përdorim të marra me qira në zonat e mbrojtura, **nga 11 subjekte**, përkatësisht: K.D 100,300 lekë, B.H 207,825 lekë, E K 90,000 lekë, A.Sh 55,011 lekë, G.L 80,000 lekë, A.K 118,000 lekë, A.E 32,337 lekë, A.D 191,500 lekë, “T. E” shpk 333,333 lekë, “D. P” shpk 227,685 lekë dhe “H” shpk 520,000 lekë.

Menjëherë

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se, subjekti e ka pranuar rekomandimin. AdZM-ja Tirane ju ka dërguar shkresë të gjithë subjekteve të lëna nga Raporti i Auditimit Përfundimtar të KLSH, më konkretisht si më poshtë:

- Shkresa Nr.161 Prot., datë 23.05.2023 “Njoftim për shlyrje detyrimi”, subjektit “A.K.”, ka shlyer detyrimin me datë 29.5.2023 duke paraqitur pranë AdZM-së Tirane mandat pagesëse.
- Shkresa Nr.162 Prot., datë 23.05.2023 “Njoftim për shlyrje detyrimi”, subjektit “A. Sh.”, ka shlyer detyrimin me datë 29.5.2023 duke paraqitur pranë AdZM-së Tirane mandat pagesëse.
- Shkresa Nr.163 Prot., datë 23.05.2023 “Njoftim për shlyrje detyrimi”, subjektit “D.P.”, ka shlyer detyrimin me datë 28.08.2023 duke paraqitur pranë AdZM-së Tirane mandat pagesëse.
- Shkresa Nr.164 Prot., datë 23.05.2023 “Njoftim për shlyrje detyrimi”, subjektit “T. E.”, ka shlyer detyrimin me datë 25.5.2023 duke paraqitur pranë AdZM-së Tirane mandat pagesëse.
- Shkresa Nr.165 Prot., datë 23.05.2023 Njoftim për shlyrje detyrimi”, subjektit “H.”, por deri tani nuk është përgjigjur shkresë tonë.
- Shkresa Nr.166 Prot., datë 23.05.2023 Njoftim për shlyrje detyrimi”, subjektit “G. L.”, ka shlyer detyrimin me datë 19.06.2023 duke paraqitur pranë AdZM-së Tirane mandat pagesëse.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË ADMINISTRATA E ZONAVE TË MBROJTURA TIRANË

Për përmirësimin e punës në të ardhmen, rekomandojmë:

A. MASA ORGANIZATIVE

Nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën me shkresën nr.892/6 prot, datë 12.01.2023, ka dërguar në Administratën e Zonave të Mbrojtura Tiranë Raportin Përfundimtar të Auditimit së bashku me rekomandimet përkatëse si vijon:

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar u konstatua se Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë ka burime të tjera të ardhura të pa arkëtuara dhe të munguara në buxhetin e shtetit. Të ardhura këto nga lëvizja e vizitorëve në drejtimin tjetër të portës hyrës që kalojnë “**pa paguar as një detyrim**” në Zonën e Mbrojtur Dajt, nga lëvizja e vizitorëve “ndërmjet teleferikut “D. E” si dhe në zonën e Karavastasë, objekteve të natyrës dhe antenat televizive të vendosura në Zonat e Mbrojtura e nuk kanë asnjë plan për menaxhimin dhe rritjen e të ardhurave me Ministrinë e vartësisë duke krijuar të ardhura të munguara mesatarisht **200,000,000 lekë**. (Ilogaritur sipas të dhënave të mara nga faqja e ëeb-it e D-E)

Veprime në kundërshtim me VKM nr.881 date 14.12.2016 “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm të Territorit” si dhe me nenin 41 (Pika 1) dhe neni 42 i ligjit nr.81/2017 “ Për Zonat e Mbrojtura (Më hollësisht trajtuar në 3 faqet 6-6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1.Rekomandimi: Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë të ushtrojnë kontrolle të vazhdueshme për arkëtimin e detyrimeve nga vizitorët që hyjnë në Zonën e Mbrojtur.

Menjëherë

B . MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ADZM Tirane nuk ka përllogaritur sakte dhe nuk ka marrë masa për arkëtimin e plote të **detyrimeve për tarifën e qirasë** për sipërfaqet e zonave të mbrojtura në përdorim, për **6 subjekte** në vlerën **1,141,962 lekë ardhura të munguara**, në kundërshtim me ligjin nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, me VKM nr. 1064 date 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin pyjor dhe kullotave” ndryshuar me VKM nr. 1156 datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e ardhurave gjeneruara nga tarifën që paguhen në zonat mbrojtura të masës dhe kritereve përdorimit tyre”, lidhja 1, pika 3/a/1, pika 3/b/1 dhe pika 3/c/1 etj (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet 6-7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë të ndjekë gjithë procedurat administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **1,141,962 lekë, tarife qiraje e pa paguar**, për sipërfaqet në përdorim të marra me qira në zonat e mbrojtura, nga **6 subjekte**, përkatësisht: K.D 100,300 lekë, B.H 207,825 lekë, E K 90,000 lekë, A.E 32,337 lekë, A.D 191,500 lekë, “ H“ Shpk 520,000 lekë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar u konstatua se **Spektori i Manaxhimit në AdZM-Tiranë** nuk kanë informacion të plotë për subjektet private me kontrata të lidhura provizorisht në Malin e Dajtit mbi sasinë e gjedhëve dhe të imtave. Referuar të dhënave nga sistemi “Ruda “ dhe nga Ministria e Bujqësisë me kontrata të lidhura për numër më të vogël ka likuiduar më pak **42,700 lekë** për vitin 2020. Veprime në kundërshtim me nenin 3 pika 2 e ligjin 81/2017 si dhe rregullores



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Performancës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË ADMINISTRATA E ZONAVE TË MBROJTURA TIRANË

me nr.72/1 date 15.06.2015. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 7-7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Tiranë të ndjeke gjithë procedurat administrative dhe në gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e detyrimit nga subjekti F.D për **42,700 lekë.**

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi

GRUPI I AUDITIMIT

1. V. B., Përgjegjës Grupi
2. Sh. H. , auditues

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

A.Z.